



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në
"Infermieristikë"**

ofruar nga

Universiteti "Fan S . Noli" Korçë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Indrit Bimi

Dr. Evis Allushi

Tetor/2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Master Profesional në "Infermieristikë"**

1	IAL aplikues:	Universiteti "Fan S. Noli", Korçë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Infermierisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në "Infermieristikë"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMAS Nr. 177, datë 06.05.2015
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Vendim Senati Nr. 575, datë 01.10.2018 dhe miratuar me shkresë MASR Nr. 1287/1, datë 15.03.2019
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 46, datë 15.03.2022
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i II- të
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2022-2023: 11 PAE/ 12 PAK 2023-2024: 7 PAE/ 7 PAK 2024-2025: 13 PAE/ 5 PAK
18	Numri i studentëve:	➤ 2022 – 2023: 29 studentë ➤ 2023 – 2024: 38 studentë ➤ 2025 – 2026: 40 studentë
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Programi i studimit të Ciklit të Dytë MASTER PROFESIONAL NË INFERMIERISTIKË ofrohet nga Departamenti i Infermierisë, Fakulteti i Shkencave Naturore Dhe Humane, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë.

Ky program u hap pas vendimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Nr. 177, datë 06.05.2015 për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë: Master Profesional në “Infermieristikë” (90 ETCS) dhe ka filluar në vitin akademik 2015-2016. Hapja mbështet tek: Ligji Nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për Arsimin e Lartë”, i ndryshuar; Udhëzimi Nr.15, datë 04.04.2008 të MASH “Për Organizimin e Studimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”, Udhëzimi Nr.4, datë 22.01.2008 i MASH “Për Hapjen Mbylljen dhe riorganizimin e Programeve të Studimit Master të Nivelit të Parë dhe të Dytë” dhe Udhëzimi Nr. 30, datë 26.09.2007 i MASH “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit që duhet të paraqesë subjekti juridik, për hapjen e një Institucioni Privat të Arsimit të Lartë ose Programeve të reja të Studimit në Ciklin e Parë dhe Ciklin e Dytë të Studimeve”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 29 dt 28.07.2008 të MASH. Në vitin akademik 2018-2019

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë: Master Profesional në “Infermieristikë” u ristrukturua në Programin e Studimit të Ciklit të Dytë: Master Profesional në “Infermieristikë” me 60 kredite (ETCS). Ristrukturimi u krye pas ndryshimeve në Legjislacion bazuar tek Vendimi Nr. 575, datë 01. 10. 2018, i Senatit Akademik të Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë, dhe në Vendimin Nr. 162, datë 21. 02. 2018, “Për riorganizimin e programeve ekzistuese të Ciklit të Dytë Master Profesional”, mbi ristrukturimin e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë: Master Profesional në “Infermieristikë” (90 ETCS) në Programin e Studimit të Ciklit të Dytë: Master Profesional në “Infermieristikë” (60 ETCS).

Master Profesional në “Infermieristikë” i takon nivelit 7, referuar Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, sipas VKM 310, date 11.5.2022, Programi i Studimit të Ciklit të Dytë:, me kohë normale, në gjuhën shqip, i kodifikuar me kod të propozuar 71MP0913S. Programi i studimit i ciklit të dytë Master Profesional në specialitete u ofron mundësinë për formim të vazhdueshëm dhe kualifikim të mëtjshëm profesional të gjithë studentëve që kanë mbaruar ciklin e parë të studimeve në infermieri të përgjithshme , ose fusha të përafërta, apo të ngjashme me te. Programi i studimit pas diplomimit mbështet dhe zgjeron kompetencat e fituara në nivelin bazë të studimit, duke theksuar aplikimin e teorive në praktikën infermierore, në edukim, zbatimin dhe zhvillimin e aftësive në kërkim.

Ky program përgatit infermiere për të qenë lidera në infermieristikë dhe fushat e shërbimit shëndetësor , të aftë të funksionojnë si specialistë në klinikë, si këshillues, si edukator, si

administrator dhe kërkues në gjithë specialitetet e profesionit sipas kërkesave dhe përparësive kombëtare dhe nevoja në ndryshim të shoqërisë.

Ky program siguron bazat për studime të mëtejshme në infermieristikë. Për më tepër nxit përgjegjësitë dhe angazhimin në mësimin gjatë gjithë jetës, gjë që çon në përmirësimin e kujdesit cilësor. Kuadri i përgjithshëm formues i programit hartohet duke marrë në konsideratë dhe udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës "Për organizimin e studimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë". Kurset e ofruara nga ky program janë përzgjedhur me qëllim që studentët të kenë njohuri të specializuara që sot kërkohen në fushën e Infermieristikës, duke marrë parasysh në të njëjtën kohë dhe duke iu përgjigjur karakteristikave dhe nevojave të institucioneve shëndetsore shqiptare dhe evropiane.

Kuadri i përgjithshëm formues i Programit të Studimit përbëhet nga:

A. Lëndët e Formimit Bazë, të cilat synojnë që studenti të pajiset me njohuritë bazë metodologjike dhe kulturë të përgjithshme në fushën e Bioetikës dhe të Drejtës në Infermieristikë.

B. Lëndët e Formimit Karakterizues, të cilat synojnë pajisjen e studentit me njohuri të avancuara në Menaxhim shëndetsor e inferior, Fizpatologji, Edukim dhe Promocion shëndetsor dhe Infermieristikë e avancuar në specialitete si kirurgji, pediatri, geriatri, obstetrike-gjinekologji, kujdes paliativ, etj.

C. Lëndët ndërdisiplinore / integruese dhe ato me zgjedhje, të cilat synojnë aftësimin e studentëve me njohuri të avancuara në Metodologji kërkimi dhe Epidemiologji, Këndvështim holistik i shëndetit dhe sëmundjes, Infeksionet spitalore dhe Teknologji informacioni të aplikuara në shëndetsi.

D. Lëndët plotësuese, të cilat synojnë pajisjen e studentit me njohuri specifike të Anglishtes Profesionale dhe të Praktikës Profesionale.

Objektivat formuese të Programit të Studimit janë përgatitja e studentëve me njohuri të avancuara në fushat kryesore të Infermieristikës dhe kujdesit shëndetsor ; zgjerimi i kompetencave të fituara në nivelin bazë të studimit, duke theksuar aplikimin e teorive në praktikën infermirore, në edukim, zbatimin dhe zhvillimin e aftësive në fushën kërkimore; përgatitja e infermierëve për të qenë drejtues të aftë në fushën e infermieristikës dhe fushat e shërbimit shëndetsor, të aftë të funksionojnë si specialistë në klinikë, si këshillues, si edukatorë, si administratorë dhe kërkues në gjithë specialitetet e profesionit sipas kërkesave dhe përparësive në institucionet shëndetsore dhe nevojat për ndryshim të shoqërisë; si dhe siguri i bazave për studime të mëtejshme në infermieristikë duke nxitur përgjegjësitë dhe angazhimin në mësimin gjatë gjithë jetës duke përmirësuar cilësinë e kujdesit shëndetsor. Mundësitë për punësim. Studenti me formim të tillë mund të punojë si infermier specialist; ose mund të punojë si specialist pranë qendrave të shërbimit shëndetsor parësor, dytësor dhe terciar, publik dhe privat.



Ky Program Studimi i Ciklit të Dytë, suksesin e tij e bazon në kompetencat e stafit akademik që do të zhvillojë Programin e Studimit; në infrastrukturën moderne që është ngritur për këtë qëllim pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane, Universiteti "Fan S. Noli", Korçë, dhe në përvojën e fituar ndër vite, gjatë zhvillimit të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë: Master Profesional në "Infermieristikë".

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Raporti i vlerësimit të jashtëm, është dokument i hartuar në kuadër të akreditimit të programit të studimit Master Profesional në "Infermieristikë", i ofruar nga Universiteti "Fan S . Noli" Korçë. Ky raport përmbledh procedurën e realizimit të këtij procesi, vlerësimin përkundrejt standardeve dhe kriterëve për programin e studimit, pjesë e Kodit të Cilësisë, gjetjet konstatimet dhe vlerësimin për çdo fushë, vlerësimin e përgjithshëm për përmbushjen e standardeve dhe kriterëve respektive.

Në mbështetje të hartimit të raportit dhe gjykimeve të arritura janë shqyrtuar një sërë dokumentash dhe informacionesh të vëna në dispozicion nga Institucioni në faza të ndryshme të vlerësimit, nga ASCAL si dhe informacione të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. Procesi i vlerësimit është koordinuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL Msc.Rajna Lila nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit AMS. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i përbërë nga Dr. Indrit Bimi dhe Dr. Evis Allushi.

Vizita në Universitetin "Fan S . Noli" Korçë është zhvilluar në datat 17.03.2025-18.03.2025. Në institucion janë kryer disa takime të rëndësishme me aktorë dhe faktorë të institucionit në funksion të programit të studimit.

Grupi i vlerësimit të jashtëm, në këtë raport është përpjekur të pasqyrojë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit. GVJ jep vlerësim pozitiv të arritjeve të bëra nga Universiteti "Fan S . Noli" Korçë në ofrimin e një programi të mire të Masterit Profesional në "Infermieristikë". Gjithashtu, jep disa sugjerime/rekomandime, të cilat vlerësohet se do të ndihmojnë stafin akademik dhe administrativ për të arritur objektivat e tyre, të krahasueshëm me nivelet ndërkombëtare për gjeneratat e ardhshme të Infermierive.

GVJ vlerëson maksimalisht angazhimin e institucionit, Grupit të Vlerësimit të Brendshëm dhe personelin akademik për gadishmërinë e treguar në dhënien e informacioneve të kërkuara në funksion të procesit gjatë vizitës në institucion.

Më datë 01.08.2025, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 36/100 Prot., Datë 01.08.2025, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet me shkresë zyrtare Nr. 1521/1 Prot, Datë 12.09.2025.

Memo, mbi komentet e institucionit lidhur me Draft- Raportin e Vlerësimit të programit të studimit Master Profesional në "Infermieristikë" të Universitetit "Fan.S.Noli", Korçë.

GVJ shqyrtoi komentet e bëra nga Institucioni lidhur me draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Më poshtë po rendisim sqarimet tona për komentet e bëra prej institucionit.

Konkretisht:

1. Lidhur me komentin nga IAL, Standardi I,1: Sepse ka mungesë të njësisë kryesore dhe nuk ploteson kriteret e hierarkise sipas LAL, kjo dhe e shprehur në kriterin përkatës. *GVJ, vlerësojmë komentin e Institucioni por i qëndron mendimit në lidhje me atë cfar është hartuar në draft-raport në të cilin nuk ka dryshime në raport.*
2. Lidhur me komentin nga IAL, Standardi I,2: Sepse njësia kryesore është jashtë fushës së programeve mjeksore dhe të shëndetit. Cdo vendimarrje e njësisë kryesore nuk përbën ekspertizën përkatëse duke u kufizuar vetëm në vendimarrje departamenti *GVJ, vlerësojmë komentin e Institucioni por i qëndron mendimit në lidhje me atë cfar është hartuar në draft-raport në të cilin nuk ka dryshime në raport.*
3. Lidhur me komentin nga IAL, Standardi I,2: Rrezohet si argument sepse s'ka asnje aspekt ligjor që e përjashton mungesen e aktiviteteve. Përsa kohe bëhen aktivitete sensibilizimi dhe mësimi bëhet në klasa. *GVJ, vlerësojmë komentin e Institucioni por i qëndron mendimit në lidhje me atë cfar është hartuar në draft-raport në të cilin nuk ka dryshime në raport.*
4. Lidhur me komentin nga IAL, Standardi 1.3/kriteri 4: *GVJ, vlerësojmë komentin e Institucioni por i qëndron mendimit në lidhje me atë cfar është hartuar në draft-raport në të cilin nuk ka dryshime në raport.?*
5. Lidhur me komentin nga IAL, Standardi II.1/kriteri 7: *Vlerësojmë komentin e Institucioni por i qëndron mendimit në lidhje me atë cfar është hartuar në draft-raport në të cilin nuk ka dryshime në raport.*

6. Lidhur me komentin nga IAL, Standardi II.2/ kriteri 1: Programi ka lektore të jashtëm të praktikës, por GVJ e gjykon që të shtohen orët e praktikës dhe mësimdhënësit klinik.

Vlerësojmë komentin e Institucioni por i qëndron mendimit në lidhje me atë cfar është hartuar në draft-raport në të cilin nuk ka dryshime në raport.

7. Lidhur me komentin nga IAL, Standardi II.2/ kriteri 2: *Vlerësojmë komentin e Institucioni por i qëndron mendimit në lidhje me atë cfar është hartuar në draft-raport në të cilin nuk ka dryshime në raport duke qënë se kriteri kërkon laborantin.*

8. Lidhur me komentin nga IAL, Standardi II.3/kriteri 2: *Vlerësojmë komentin e Institucionit por i qëndron mendimit në lidhje me atë cfar është hartuar në draft-raport në të cilin nuk ka dryshime në raport duke qënë se kriteri kërkon module”.*

9. Lidhur me komentin nga IAL, Standardi II.3//Kriteri 3: *Vlerësojmë komentin e Institucionit por i qëndron mendimit në lidhje me atë cfar është hartuar në draft-raport në të cilin nuk ka dryshime në raport duke qënë se nuk përmendet në cilin nen të rregullores është kjo.*

10. Standardi II.4/ kriteri 1: Komenti është qartazi. Nuk ka raporte përkatëse. Në cilin nen të rregullores parashtrohet ky standard apo dhe paragraf që bën lidhjen me punësimin dhe sipas protokolleve vendase dhe ndërkombëtare?

11. Standardi II.4/ kriteri 3: Vendimi nr 823 është një përkthim i direktivës europiane për profesionet e rregulluara dhe sic dihet që cdo program infermieror përshtatet dhe përqaset me këtë direktive. Gjithashtu nuk paraqitet evidencë që ka një program ndërkombëtar të përafërt. Për më shumë info shikoni linksin më poshtë. <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2013:354:0132:0170:en:PDF>
Vlerësojmë komentin e Institucionit por i qëndron mendimit në lidhje me atë cfar është hartuar në draft-raport në të cilin nuk ka dryshime në raport.

12. Standardi II.4/ kriteri 4: GVB cilëson se është kohë e shkurtër studimi 1 vjecar për të krijuar mundësinë e aplikimit për mobilitete. *Vlerësojmë komentin e Institucionit por i qëndron mendimit në lidhje me atë cfar është hartuar në draft-raport në të cilin nuk ka dryshime në raport.*

13. Standardi II.4/ kriteri 7: GVB citon që nuk ka master shkencor, por Alumni bën gjurmim të studentëve dhe evidentohet përkatësisht në databazën e Universitetit.

14. Standardi II.5/kriteri 2: Është vendosur një evidencë e nxjerr nga faqja web që ka mangësi në kordinim mes njësive përkatëse. *Vlerësojmë komentin e Institucionit por i qëndron mendimit në lidhje me atë cfar është hartuar në draft-raport në të cilin nuk ka dryshime në raport.*
15. Standardi II.5/Kriteri 3: Citohet nga RVB që ka qëndrueshmëri si program, por nuk paraqet asnjë raport apo relacion për përmirësim të këtij programi nga të gjithë aktorët përkatës e përmendur në këtë kriter.
16. Standardi II.6/kriteri 1: Nga raportet e dërguar paraqitet mangësi në kërkimin shkencor tek pedagoget përkatës. Nëse keni një evidencë tjetër kur paraqitet qëndrueshmëri në kërkimin shkencor, ju lutem na evidentoni.
17. Standardi II.6/ Kriteri 3: GVB i quan aktivitetet sensibilizuese si aktivitete kërkimore. Gjykoj t'ja lëmë bordit të akreditimit që të gjykojnë në vazhdimësi për emërtim e aktiviteteve përkatëse.
18. Standardi II.7/kriteri 1: *Vlerësojmë komentin e Institucioni por i qëndron mendimit në lidhje me atë cfar është hartuar në draft-raport në të cilin nuk ka dryshime në raport duke qënë se kriteri projekte kërkimore në fushën e infermieristikes.*
19. Standardi II.7/Kriteri 2: *Vlerësojmë komentin e Institucionit por i qëndron mendimit në lidhje me atë cfar është hartuar në draft-raport në të cilin nuk ka dryshime në raport duke qënë se kriteri nuk parashikohet në rregullore.*
20. Standardi II.7/ Kriteri 3: Njësia përgjegjëse është departamenti, jo njësia kryesore e cila është jashtë profilit. E dyta nëse ka një evidence që konferenca është në fushën mjeksore, na e evidentoni?
21. Standardi II.7/Kriteri 4: *Vlerësojmë komentin e Institucioni por i qëndron mendimit në lidhje me atë cfar është hartuar në draft-raport në të cilin nuk ka dryshime në raport duke qënë se nuk raport apo evidence që të plotësojë këtë kriter.*
22. Standardi III.5/Kriteri 3: Sipas vkm nr. 41 janë të ndara disiplinat. E dyta nuk shkruhet në rregullore se cilat janë lëndët. Sygjerojm si gjv të ketë një vendim departamenti për këtë gjë, pra të lihet një procedurë.
23. Standardi III.4: *Vlerësojmë komentin e Institucioni por i qëndron mendimit në lidhje me atë cfar është hartuar në draft-raport në të cilin nuk ka dryshime në raport duke qënë se nuk ka evidence të pajisjeve laboratorike dhe vizita në IAL e theksoj këtë gjë,*

duke qënë se ishte investuar nga IAL për laborator Fizioterapie, kur nuk kishte degë studimi Fizioterapi.

24. Lidhur me komentin për Standardin IV. 1./ Kriteri 7, ku në bazë të evidentimeve të GVJ praktikat udhëhiqen nga specialistët në kurset përkatëse bazuar në vendimin, duam të falenderojmë institucionin për materialin shtojcë lidhur me orarin e këtyre praktikave. *GVJ, vlerësojmë komentin e Institucioni por i qëndron mendimit në lidhje me atë cfar është hartuar në draft-raport .*
25. Lidhur me komentin për standardin IV.2 /kriteret 2, 3, 5, GVJ evidentoi se praktikat e studentëve të këtij cikli studimi zhvillohen në institucionet shëndetësore me të cilat ky institucion ka marrëveshje, sipas edhe kurrikulës që ata kanë. *GVJ mer parasysh komentin e institucionit, ndaj raporti ndryshon. Për këtë standart, IV.2, GVJ ndryshon vlerësimin nga pjesërisht në plotësisht.*
26. Lidhur me komentin për standardin IV.2 /kriteri 4, GVJ pas evidentimit që ka bërë lidhur me mungesën e programeve simulatore specifike, nuk e ka trajtuar këtë element si kërkesë detyruese apo ligjore për akreditim. *Do të ishte në nder të këtij institucioni nëse në të ardhmen do të realizohej një program i tillë, gjë e cila pranohet edhe nga ana e vetë institucionit, për sa më sipër nuk ka ndryshime në raport.*
27. Lidhur me komentin për standardin IV.3 kriteri 1, GVJ e vlerëson komunikimin e drejtpërdrejtë të pedagogëve me studentët në auditor, por duke qënë se GVB e ka evidentuar si një formë komunikimi pedagog-student edhe komunikimin npm platformave digjitale, për këtë arsye edhe GVJ ka kërkuar evidenca. Për sa më sipër nuk ka ndryshime në raport.
28. Lidhur me komentin për standardin IV.3 kriteri 3, 4, 6, GVJ në asnjë moment nuk ka vënë në diskutim nivelin e fondit të bibliotekës së institucionit, por faza në të cilën ndodhej, rikonstruksioni, nuk na e ka bërë të mundur që ne të shohim nga afër këto ambiente. *GVJ mer parasysh komentin e institucionit, ndaj raporti ndryshon, por nuk ndryshon gjë në vlerësimin përfundimtar.*

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Infermieristikë”.

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programet e studimit që ofrohen nga UNIKO nuk bien ndesh me interesat kombëtare. UNIKO vepron në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore. Misioni i UNIKO (Statuti i UNIKO) synon arsimimin e lartë gjithëpërfshirës të studentëve vendas e të huaj, studimet dhe kualifikimet e mëtejshme. Evidenca: 1.1 Statuti i Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë, neni 2,3. Dispozita të përgjithshme, Neni 1,2,3,4. 1.3 Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO (2022-2027), Strategjia e zhvillimit dhe rëndësia fq. 3.
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Strategjia e UNIKO ka disa objektiva specifike të cilat fokusohen tek organizimi institucional, mësimdhënia, kërkimi shkencor, sigurimi i brendshëm i cilësisë, veprimtaritë shërbyese si dhe marrdhëniet me jashtë/ndërkombëtarizimi. Programi i studimit Master Profesional në “Infermieristikë” i ofruar nga Departamenti i Infermierisë është në linjë me synimet dhe misionin e institucionit ashtu sikundër paraqitet në statutin e institucionit. Evidenca: 1.1 Statuti i Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë, neni 2,3. Dispozita të përgjithshme, Neni 1, 2, 3, 4. 1.3 Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO (2022-2027), Strategjia e zhvillimit dhe rëndësia fq. 3. 2.4 Plani strategjik për zhvillimin e programit 2.5 Rregullore e programit të studimit, Korniza konceptuale e programit të studimit “Master Profesional në “Infermieristike”, Objektivat formues dhe karakteristikat e programit të studimit,

	<i>Struktura e planit mësimor të programit të studimit.</i> <i>3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë 4.3 Tabela e programeve të studimit në ciklin e I-rë, të II-të dhe të III-të të studimeve, që ofrohen në Njësinë bazë përgjegjëse.</i> <i>5.22</i> <i>https://arsimi.gov.al/ligji-nr-80-2015-per-arsimin-e-lartedhe-kerkimin-shkencor-ne-institucionet-e-arsimit-te-larte-nerepubliken-e-shqiperise-dhe-aktet-nenligjore-ne-zbatim-te-tij-2/</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike së Institucionit.	Strategjia e UNIKO ka disa objektiva specifike të cilat fokusohen tek organizimi institucional, mësimdhënia, kërkimi shkencor, siguri i brendshëm i cilësisë, veprimtaritë shërbyese si dhe marrdhëniet me jashtë/ndërkombëtarizimi. Programi i studimit i ofruar nga DI është në linjë me synimet dhe misionin e institucionit ashtu sikundër paraqitet në statutin e institucionit. Evidenca: <i>1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, neni 2,3. Dispozita të përgjithshme, Neni 1, 2, 3, 4. 1.3 Plan Strategjik i Zhvillimit të Universitetit të Korcës "Fan S. Noli" (2022-2027)</i> <i>2.5 Rregullore e programit të studimit, Korniza konceptuale e programit të studimit "Master Profesional në "Infermieristike", Objektivat formues dhe karakteristikat e programit të studimit, Struktura e planit mësimor të programit të studimit.</i> <i>2.3 Rregullore e Njësisë Bazë 2.2 Rregullore e Njësisë Kryesore</i>
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prijet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Referuar RVB-ës gjykojmë që Programi i studimit Master Profesional në "Infermieristikë", hartohet e zhvillohet në përputhje të plotë me profilin e studimeve në UNIKO, referuar Statutit të UNIKO, Rregullores së UNIKO dhe Planit Strategjik të Zhvillimit të UNIKO. Evidenca: <i>1.1 Statuti i UNIKO 1.2 Rregullore e UNIKO 1.3 Plan Strategjik i Zhvillimit të UNIKO (2022-2027)</i> <i>1.27 Analizës vjetore të UNIKO 2023-2024 1.28 "Raporti i Vlerësimit për Transformimin e UNIKO", të 12 dt.15.07.2024, hartuar nga AADF dhe READ</i> <i>2.3 Rregullore e njësisë bazë 2.4 Rregullore e Programit të</i>

	<i>studimit 3.7 Analiza vjetore e njësisë bazë 2023-2024</i>			
KONKLUZIONE	Programi i studimit Master Profesional “Infermieristikë”, hartohet e zhvillohet në përputhje të plotë me profilin e studimeve në UNIKO, referuar Statutit të UNIKO, Rregullores së UNIKO dhe Planit Strategjik të Zhvillimit të UNIKO.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Gvj në bazë të programit të studimit Master profesional në “Infermieristikë” dhe në bazë të nenit 59, pika 6 evidentohet që ka As. Lektor që japin mësim në këtë program studimi, pra nuk kanë ciklin e 3-të pasardhës. <i>Por GJVJ rekomandon që as/lektorët që janë në proces doktoreture janë të mjaftueshëm nga ana akademike.</i> Evidenca: <i>*LIGJ Nr. 80/2015 PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË. Neni 59 Kategoritë e personelit akademik/6. Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Njësia kryesore nuk është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore, bazuar në VKM nr 41 tek tabela, ku përcaktohen fushat dhe veprimtaritë kryesore. Duhet të përmirësohet sepse nuk është në fushën akademike të njësisë kryesore, duke rekomanduar formulimin “Shkencave të shëndetit ose mjeksore”. Evidenca: <i>*VENDIM Nr. 41, datë 24.1.2018 PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË/ Tabela 2.</i>

Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Njësia bazë është plotësisht në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore, bazuar në VKM nr 41 tek tabela, ku përcaktohen fushat dhe veprimtaritë kryesore. Evidenca: <i>*VENDIM Nr. 41, datë 24.1.2018 PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË/ Tabela 2.</i>		
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	Ky program përjashtohet nga kriter.		
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Nuk ka evidencë për këtë kriter dhe nuk plotësohet si kriter.		
Konkluzionet	Njësia bazë është plotësisht në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore, bazuar në VKM nr. 41 tek tabela, ku përcaktohen fushat dhe veprimtaritë kryesore. Por njësia kryesore nuk është në përputhje me fushën akademike.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi
----------	-----------

Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	UNIKO ka në Rregulloren dhe Statutin e vet njësitë akademike dhe administrative specifike të cilat bashkëpunojnë me njëra tjetrën me qëllim mbarëvajtjen e programit të studimit. Secila Njësi ka të përcaktuara detyrat dhe rolin e vet. Me qëllim ofrimin e këtij programi studimi, njësitë bashkëpunojnë me njëra tjetrën. Evidenca: <i>Shtojca -3.6 Raportet vjetore të NJSBC</i> <i>Shtojca -3.25 Analizë vjetore e punës së FSHNH Shtojca - Analiza vjetore e Njesisë Bazë</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Janë paraqitur një sërë marrëveshesh, por konkretisht nuk ka një raport analitik si këto marrëveshje funksionojnë në raport me programin e studimit Master Profesional "Infermieristikë". Përjashtim bëjnë realizimi praktikave mësimore që janë me institucione vendase lokale. Evidenca: <u><i>2.13 LISTA E MARRËVESHJEVE TË BASHKËPUNIMIT ME INSTITUCIONE NË.pdf</i></u>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Strukturat bashkëpunuese ku studentët kryejnë praktikat profesionale janë: - Shërbimi Spitalor Rajonal, Korçë. - Drejtoria Rajonale Shëndetsisë Korçë - Qendra e Kujdesit Paliativ "Mary Potter" Korçë - Kryqi i Kuq Korçë - Qendra komunitare e shëndetit mendor Korçë - Shtëpia e foshnjës - Institucionet arsimore dhe rezidenciale të personave me aftësi të kufizuara. Mendojmë që janë të mjaftueshme për të realizuar praktikat, por nuk paraqiten raporte analitike si evidenca. Gjithashtu nuk paraqiten evidenca të mobiliteteve në kuadër të programit master. Evidenca: <i>2.4 Rregullore e programit të studimit 'Master Profesional' në 'Infermieristike'</i> <i>Shtojca 2.9- Marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet</i> <i>Shtojca 2.17- Manuali i praktikës profesionale</i>

Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit duhet të bëjë raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. GVJ evidenton që nuk hartohen raporte analitike. Evidenca: 3.6 Raportet e vjetore të NJSBC 3.7 Analiza vjetore e veprimtarisë së Njesisë Bazë Shtojca -3.25 Analizë vjetore e punës së DI.			
Konkluzione	Janë paraqitur një sërë marrëveshjesh, por konkretisht nuk ka një raport analitik si këto marrëveshje funksionojnë në raport me programin e studimit Master Profesional “Infermieristikë”. Mendojmë që janë të mjaftueshme për të realizuar praktikat, por nuk paraqiten raporte analitike si evidenca. Gjithashtu nuk paraqiten evidenca të mobiliteteve në kuadër të programit master. GVJ evidenton që nuk hartohen raporte analitike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të përcaktuar nga VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, 'Për elementet e programeve të studimit që ofrohen nga institucionet e arsimit të lartë'. Në fund të programit të studimit, studenti pajiset me diplomë të ciklit të dytë "Master Profesional në Infermieristikë". GVJ evidenton që për disa lëndë nuk janë në përputhje me disiplinat (A+B+C+D). Konkretisht: 1. Teknologji informacionit të aplikuar në shëndetesi (B) + Gjuhë e huaj për qëllime specifike (C) janë tek Disiplina D sipas VKM nr 41. 2. Infeksionet spitalor është lene disiplina D, kur ajo mund të jete disiplina C dhe I është lene një hapësirë shumë e vogël Praktikes. Infeksionet Spitalore duhet të kalojnë lene me zgjedhje dhe lëndet si Infermieristika në Komunitet të kalojnë lende me detyrim sepse fusha e masterit e përcakton. 3. Kursi Fisiopatologji nuk është e kategorisë B, mund të hyjë tek kategoria A ose C. Gjithashtu paraqitet dhe kursi Njohuri të avancuara në shëndet që mund të kenë përafrim në të njëjtin kurs. 4. Vlerësimi i avancuar i shëndetit mund të zëvendësohet me tog fjalësh Vlerësimi i avancuar infermior. https://courseoutline.auckland.ac.nz/dco/course/NURSING/773 5. Kursi bazat e menaxhimit dhe menaxhimi dhe lidhshipi në infermieri janë në të njëjten fushë dhe nuk duhet të jete Bazat e menaxhimit. 6. Bioetika dhe e drejta në infermieristike mund të behen në një lende dhe të jenë module të vecanta Bioetika duhet të ndërrohet emri në Etika në Infermieristike dhe E drejta në Infermierike.

	7. Tek lëndët me zgjedhje duhet te zevendesohet Njohuri të avancuara dhe të vendoset Infermieristika e avancuar.
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi i studimit evidentohet që një numër të madhe kursesh mjeksore dhe jo infermieristikash. Pra vërehet një numër dominant i kurseve të dhënë nga mjekët dhe jo infermierët. Evidenca: <i>Shtojca 2.4 - Rregullore e programit të studimit 'Master Profesional' në 'Infermieristikë'.</i>
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Gvj rekomandon që duke qënë se fusha e infermieristikës dhe vetë masteri professional, janë në profile praktike dhe jo teorike. Bazuar dhe në VKM e re mbi profesionet e rregulluar VKM nr 823. <i>GVJ evidenton plotësimin kryesisht të këtij kriteri sipas legjislacionit vendas.</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë	N/A

organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	N/A
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	UNIKO nuk është një Institucion i Arsimit të Lartë me status të veçantë.

Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i studimit “Master Profesional” në “Infermieristikë” nuk paraqitet në evidencë që ka ngjashmëri me një program brenda dhe jashtë vendit. Edhe gjatë takimeve me stafet nuk u evidentua. Evidenca: <i>Shtojca 2.4 - Rregullore e programit të studimit ‘Master Profesional’ në ‘Infermieristikë’</i> <i>Shtojca 2.6- Plani mësimor i programit të studimit ‘Master Profesional’ në ‘Infermieristikë Shtojca</i> <i>2.7- Programet lëndore të programit të studimit ‘Master</i>
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi i studimit “Master Profesional” në “Infermieristikë”, i ofruar nga DI, ka kodin përkatës sipas fushës së studimit dhe klasifikimit të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Lëndët dhe modulet që realizohen në këtë program studimi janë pajisur me një kod unik, i cili përputhet me kodin që ka në syllabus dhe programin mësimor. Evidenca: <i>Shtojca 2.1.5: Praktika e kodifikimit të programit të studimit</i>
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ky nuk është një program i përbashkët por ofrohet vetëm nga IAL-ja.
Konkluzione	<i>GVJ evidenton që për disa lëndë nuk janë në përputhje me disiplinat (A+B+C+D).</i> <i>Programi i studimit evidentohet që një numër të madhe kursesh mjeksore dhe jo infermieristikash. Pra vërehet një numër dominant i kurseve të dhënë nga mjekët dhe jo infermierët.</i> <i>Programi i studimit “Master Profesional” në “Infermieristikë” nuk paraqitet në evidencë që ka ngjashmëri me një program brenda dhe jashtë vendit. Edhe gjatë takimeve me stafet nuk u evidentua.</i>
Shkalla e përmbushjes	Nuk Përmbushet Përmbushet Përmbushet

së standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
		X		

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Programi i studimit “Master Profesional” në “Infermieristikë” zhvillohet në Departamentin e Infermierisë pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane. DI është organizuar në përputhje me ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Autoritetet drejtuese janë: Dekani, drejtuesit e departamenteve dhe koordinatori i programit. Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane: • Departamenti Biologji-Kimisë; • Departamenti i Infermierisë; • Departamenti i Informatikës; • Departamenti i Matematikës dhe Fizikës; • Departamenti i Shkencave Sociale; Departamenti disponon 5 doktorë të shkencave, 5 në proces doktore dhe 2 MSc, duke arritur një total prej 12 pedagogësh efektivë për vitin akademik 2024-2025 staf akademik efektive, nga 7 që parashikon minimalisht Ligji i Arsimit të Lartë 80/15. Gjithashtu, departamenti ka edhe personel me kohë të pjesshme 1 Prof.Dr; 2 Dr; 25 Msc dhe respekton raportin midis personelit me kohë të plotë, atij me kohë të pjesshme dhe të ftuar në realizimin e programeve të tij të studimit. Numri i personelit akademik me kohë të plotë është i qëndrueshëm në vite. Kualifikimi i tyre me Grada dhe Tituj duhet përmiresuar. Gjithashtu, personeli mjekësor i strukturave shëndetësore spitalore dhe jospitalore është personel potencial i kualifikuar dhe specializuar në fushën e shkencave mjekësore për UNIKO-në. Këshillohet të shtohen mësimdhënësit klinik. <i>Të dhëna për Departamentin e Infermierisë:</i>

Tituj/ grada	2022 – 2023		2023 – 2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	1	-	1	-	1
Prof. Asoc.	-	-	-	-	-	-
Dr./PhD.	5	1	4	1	5	2
Msc.	6	22	7	21	7	25
Totali	11	24	11	23	12	28

Shumica e stafit me kontratë është e angazhuar me kohë të plotë në institucionet shëndetësore, duke krijuar një lidhje të fortë midis mësimdhënies në auditor dhe praktikës profesionale.

Evidencat:
Shtojca 5.26 - [https://unkorce.edu.al/Struktura organizative / Organigrama](https://unkorce.edu.al/Struktura_organizative_Organigrama)
Shtojca 2.4 - Rregullore e programit të studimit "Master Profesional" në "Infermieristikë"
Shtojca 2.8- Jetëshkrimet e stafit të përfshirë në programin e studimit

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Nuk evidentohet të ketë laborant në laboratoret e DI-së. Evidenca: <i>Shtojca 2.20- Grafiku i praktikave spitalore të studentëve</i> <i>Shtojca 3.7- Analiza vjetore e veprimtarisë së njësive bazë</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili	Për të lehtësuar ndjekjen dhe këshillimin e procesit mësimor, si dhe ecurinë e programeve të studimit, përgjegjësi i Departamentit ka emëruar koordinorin e programit të studimit "Master Profesional" në "Infermieristikë". Detyrat dhe funksionet e koordinorëve janë të specifikuar në rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane, kreu

është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	II, neni 14. Shtojca 2.10- Vendimi i Njesisë Bazë për emërimin e koordinatorit të programit të studimit. Evidenca: <i>Shtojca 2.3 - Rregullorja e Njesisë Kryesore</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me studentët</i>			
Konkluzione	Njësi kryesore ka në përbërjen e saj 5 departamente. Departamentin i Infermierisë, si njësi bazë përgjegjëse për programin “Master Profesional në Infermieristikë” funksionon në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin për arsimin e lartë dhe aktet nënligjore përkatëse. <i>Këshillohet të shtohen mësimdhënësit klinik. Nuk evidentohet të ketë laborant në laboratorët e DI-së.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Departamenti i Infermierisë është përgjegjës për programin e studimit ‘Master profesional’ në “Infermieristikë”, dhe disponon informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Evidenca: <i>Shtojca 2.4 - Rregullorja e programit të studimit</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të	Programi i studimit “Master Profesional” në “Infermieristikë” përmban pothuaj të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e tij, të përcaktuar në VKM nr. 41, datë 24.01.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Kjo e evidentuar dhe me shtojcën e planit mësimor të ASCAL. Në planin mësimor ka lëndë, por nuk ka prezencë të moduleve.

lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Evidenca: <i>Shtojca 2.2- Rregullore e DI Shtojca 2.4 - Rregullorja e programit të studimit</i>			
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Sipas DI thuhet qe kriteret specifike të pranimit dhe kuotat përcaktohen nga njësia bazë dhe i dërgohen njësisë kryesore dhe më pas Rektoratit. Por nuk ka një evidence në lidhje me diplomat që mund të aplikojnë dhe kush janë prioritet për pranimet në master. Evidenca: <i>Shtojca 3.8- Vendim për kriteret e pranimit në programin e studimit 'Master Profesional' ne 'Infermieristike'</i> <i>Shtojca 3.24- Vendim departamenti për ngritjen e komisionit ad hoc për pranim dhe ekuivalentim të krediteve</i>			
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Sipas evidencave të paraqitura ka mangësi në plotësimin korrekt të syllabuseve dhe kanë mangësitë e mëposhtme. Ka nevojë të përmirësimit të syllabuseve.	<table> <tr> <td> 1.Bioetike (temat duhen përmiresuar dhe duhen shtuar rastet studimore si pjese e seminareve) https://www.wiley.com/en-us/Nursing+Laë+and+Ethics%2C+4th+Edition-p-9781118492338 2. E drejta ne infermieristike: Kursi duhet të jete në të njëjtën lëndë me Etiken infermiore dhe tematikat duhen përmiresuar në kuader të fushës së infermieristikës. https://www2.csu.edu.au/handbook/handbook19/subjects/NRS123.html https://www.wiley.com/en-us/Nursing+Laë+and+Ethics%2C+4th+Edition-p-9781118492338 </td> <td> 1. Bazat e menaxhimit. Fusha e menaxhimit është i mjaftueshëm tek kursi Menaxhimi dhe lidershpi në infermieri. 2. Fispatologji: Duhet shenuar togfjalesh Fispatologji ne infermieri. 3. Infermieristike e avancuar ne Kirurgji: Nuk paraqet syllabusi ndryshime nga ai bachelor. Kerkohet qe te futen raste klinike, studimore, </td> </tr> </table>	1.Bioetike (temat duhen përmiresuar dhe duhen shtuar rastet studimore si pjese e seminareve) https://www.wiley.com/en-us/Nursing+Laë+and+Ethics%2C+4th+Edition-p-9781118492338 2. E drejta ne infermieristike: Kursi duhet të jete në të njëjtën lëndë me Etiken infermiore dhe tematikat duhen përmiresuar në kuader të fushës së infermieristikës. https://www2.csu.edu.au/handbook/handbook19/subjects/NRS123.html https://www.wiley.com/en-us/Nursing+Laë+and+Ethics%2C+4th+Edition-p-9781118492338	1. Bazat e menaxhimit. Fusha e menaxhimit është i mjaftueshëm tek kursi Menaxhimi dhe lidershpi në infermieri. 2. Fispatologji: Duhet shenuar togfjalesh Fispatologji ne infermieri. 3. Infermieristike e avancuar ne Kirurgji: Nuk paraqet syllabusi ndryshime nga ai bachelor. Kerkohet qe te futen raste klinike, studimore,
1.Bioetike (temat duhen përmiresuar dhe duhen shtuar rastet studimore si pjese e seminareve) https://www.wiley.com/en-us/Nursing+Laë+and+Ethics%2C+4th+Edition-p-9781118492338 2. E drejta ne infermieristike: Kursi duhet të jete në të njëjtën lëndë me Etiken infermiore dhe tematikat duhen përmiresuar në kuader të fushës së infermieristikës. https://www2.csu.edu.au/handbook/handbook19/subjects/NRS123.html https://www.wiley.com/en-us/Nursing+Laë+and+Ethics%2C+4th+Edition-p-9781118492338	1. Bazat e menaxhimit. Fusha e menaxhimit është i mjaftueshëm tek kursi Menaxhimi dhe lidershpi në infermieri. 2. Fispatologji: Duhet shenuar togfjalesh Fispatologji ne infermieri. 3. Infermieristike e avancuar ne Kirurgji: Nuk paraqet syllabusi ndryshime nga ai bachelor. Kerkohet qe te futen raste klinike, studimore,			

	<u>2C+4th+Edition-p-9781118492338</u> 3. Menaxhimi dhe lidhshipi ne infermieristike (syllabusi duhet permiresuar ne disa tematika ne lidhje me profesionin e infermierit dhe konkretisht menaxherit infermieror te njesise shendetesore. Duhet shtuar dhe rastet studimore tek seminare). https://evolve.elsevier.com/cs/product/9788131267615?role=student 4. Infermieristika e avancuar e adultit (Duhet qe oret e seminareve te jene te pasqyruar me shume tek oret e praktikës dhe literatura duhet te jetë në përputhje me kursin dhe duhet shtuar kërkimi shkencor dhe rastet studimore në kurs. Evidentohet qe tek përshkrimi i lëndës nuk jane të qarta grupmoshat cilat trajtohet lënda (permendet togfjaleshi “të rinj, mesme, rritur” sikur jane 3 grupmosha. Aktualisht nga ana shkencore mjeksore ka moshe pediatrike, adulte dhe geriatrike. Literatura është shume e vjeter dhe nuk paraqet kursin. 5. Infeksionet Spitalore: 6. Epidemiologji dhe metodologji kerkimi 7. Vlerësimi i avancuar i shëndetit: Duke u bazuar tek literature “Nursing laboratory and diagnostic test” nuk është ndjekur i njëjti standard dhe janë të paplota. Sugjeroj qe kjo lënde	te ndryshoje menyra e vleresimit. 4. Edukim dhe kujdesi infermieror ne familje: Sugjeroj qe mjafton Infermieristika ne komunitet. 5. Njohuri te avancuar te shendetit dhe semundjes. Mjafton kursi Fispatologji ne Infermieri. https://onlineabsnprograms.com/articles/nursing-pathophysiology-101#:~:text=Ëhat%20is%20pathophysiology%20in%20nursing,these%20conditions%20and%20proceed%20accordingly 6. Infermieristika e avancuar në Pediatri 7. Lëndë me zgjedhje Njohuri të avancuara në kirurgji. Sugjeroj qe është lënde e panevojshme për sa kohe është lënda Infermieristika e avancuar në kirurgji. Njohuri te avancuar ne shendet mendor: Sugjeroj qe duhet shtuar Infermieristika e avancuar dhe të kthehet lënde me
--	--	--

	të zëvendësohet me tog fjalësh Vlerësimi i avancuar infermieror, sepse është jashtë profilit teëprogramit. https://courseoutline.auckland.ac. nz/dco/course/NURSING/773 8. Teknologji informacionit të aplikuar në shëndetësi. Duhet ndryshuar emri i lëndës dhe të jetë disiplina D me emrin Informatikë Infermirore për Praktikën e Avancuar, ose e përafërt. (Nursing Informatics for the Advanced Practice Nurse Author(s): Susan McBride, Mari Tietze. Publisher: Springer Publishing Company, Year: 2022. ISBN: 0826185258,9780826185259) 9. Gjuhe e huaj për qëllime specifike: Duhet të jetë disiplina D dhe duhet shënuar Gjuhe Angleze për Infermierinë. 10. Lëndë me zgjedhje a-Infermieristike në komunitet. Duhet të jetë lëndë me detyrim në planin mësimor dhe duhet përmiresuar literatura dhe temat si psh.: A Textbook of Community Nursing, ISBN 1032381175, 9781032381176, Routledge, 2024. b-Njohuri të avancuar në obstetric dhe gjineokologji: Duhet të zëvendësohet me togfjalësh Infermieristika e	detyrim. Njohuri të thelluara në kujdes palativ: Duhet shtuar tog fjalësh Infermieristika e avancuar dhe të kthehet lende me detyrim. 8. Praktike Institucionale. Të zëvendësohet me tog fjalëshin Praktike Profesionale sipas Vkm nr 41. 9. Punimi i diplomës. Të zëvendësohet me togfjalëshin Provimi Final/Teza Diplomës.
--	--	--

	avancuar dhe te kalojne me detyrim, jo lende me zgjedhje c- Njohuri të avancuar në pediatri: Infermieristika e avancuar dhe të kalojne me detyrim jo lende me zgjedhje			
	Evidenca: <i>Shtojca 2.7- Pogramet lëndore të programit të studimit</i>			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Programi i studimit “Master Profesional” në Infermieristikë është një program i riorganizuar në vitin akademik 2018-2019 nga 90 kredite në 60 kredite me vendimë senati Nr. 575 dhe miratuar nga MASH, por nuk ka ardhur si pasojë e përmirësimit të kurrikulës apo propozimeve nga stafi akademik dhe studentët mbi masë 20 %. Evidenca: <i>Shtojca 2.4- Rregullore e programit të studimit “Master i profesional” në ‘Infermieristikë’</i> <i>Shtojca 2.1.1 - Urdhër për riorganizimin e programit ‘Master Profesional’ ne ‘Infermieristikë’</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët;</i> <i>Takim me përfaqsesit e Kurrikulave Mësimore.</i>			
Konkluzione	Në planin mësimor ka lëndë, por nuk ka prezencë të moduleve. Sipas DI thuhet që kriteret specifike të pranimit dhe kuotat përcaktohen nga njësia bazë dhe i dërgohen njësisë kryesore dhe më pas Rektoratit. Por nuk ka një evidence në lidhje me diplomat që mund të aplikojnë dhe kush janë prioritet për pranimet në master. Ka nevojë të përmirësimit të syllabuseve. Programi i studimit “Master Profesional” në “Infermieristikë” është një program i riorganizuar në vitin akademik 2018-2019 për arsye të ndryshimit te legjislacionit, por nuk ka ardhur si pasojë e përmirësimit të kurrikulës apo propozimeve nga stafi akademik dhe studentët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	GVJ pas evidentimit të evidencave dhe takimeve me stafin nuk parashtruan një evidencë në lidhje me alumni dhe kompetencat e fituara nga masteri profesional në infermieristikë. Nuk ka të dhëna për Alumnin mbi punësimin nga Urdhërat profesionale apo dhe sektori alumnit në Universitet. <i>Evidenca:</i> <i>Shtojca 2.4- Rregullore e programit të studimit "Master i profesional" në 'Infermieristikë'</i> <i>Shtojca 2.6- Plani mësimor i programit të studimit "Master i profesional" në 'Infermieristikë'</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njësive Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me studentët;</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Organizimi i lëndëve në semestra është bërë duke u bazuar në ligjin për arsimin e lartë, si dhe në udhëzimet përkatëse. Ajo që vërehet është tek objektivat formues ka një mos rakordim të disiplinave si psh gjuhës huaj ku thuhet që është lëndë plotësuese ndërsa në kurrikulë është lëndë ndërdisiplinore. Rekomandohet riorganizim mbi 20% të kurrikulës. Kuadri i përgjithshëm formues i Programit të Studimit përbëhet nga: A-Lëndët e Formimit Bazë, të cilat synojnë që student të pajiset me njohuritë bazë metodologjike dhe kulturore të përgjithshme në fushën e Bioetikë dhe të Drejtës në Infermieristikë. B-Lëndët e Formimit Karakterizues, të cilat synojnë pajisjen e studentit me njohuri të avancuara në menaxhim shëndetësor, fizopatologji, edukimi dhe promovim shëndetësor dhe infermieristikë të avancuar. C-Lëndët ndërdisiplinore/integruese dhe ato me zgjedhje, të cilat synojnë aftësimin e studentëve me njohuri të avancuara në Metodologji kërkimi dhe Epidemiologji, Këndvështrim holistic I shëndetit dhe sëmundjes si dhe Teknologji informacioni të Aplikuara në shëndetsi.

	D-Lëndët plotësuese, të cilat synojnë pajisjen e studentit me njohuri specifike të Anglishtes Profesionale, Infeksionet spitalore dhe të Praktikës Profesionale. Evidenca: <i>Shtojca 2.6- Plani mësimor i programit të studimit "Master i profesional" në 'Infermieristikë'</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	GVJ evidenton që nuk paraqitet ndonjë evidencë që janë programe të ngjashme me ato ndërkombëtare dhe raporti teori praktike nuk është sipas vendim nr 823. Aktualisht paraqitet raporti 2:1 teori/praktikë. Duhet hequr togfjalëshi Praktikë Institucionale me Praktike Profesionale ose klinike. Evidenca: <i>VENDIM Nr. 823, datë 28.12.2023 PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 41, DATË 24.1.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË", TË NDRYSHUAR3</i> <i>4.2.2 Formimi për përgatitjen e infermierëve përbëhet nga të paktën 4 600 (katër mijë e gjashtëqind) orë formimi teorik dhe klinik, nga të cilat formimi teorik përfshin të paktën një të tretën dhe formimi praktik të paktën gjysmën e kohëzgjatjes së formimit. Institucionet që ofrojnë formimin për infermierinë janë përgjegjëse për koordinimin e formimit teorik dhe klinik përgjatë të gjithë programit të studimit. Shtojca 2.4- Rregullore e programit të studimit "Master i profesional" në 'Infermieristikë'</i> <i>Shtojca 2.6- Plani mësimor i programit të studimit "Master i profesional" në 'Infermieristikë'</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues,	Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë jo mjaftueshëm arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. GVJ evidentoi dhe në takime me stafin dhe studentët që nuk ka mundësi mobiliteti apo evidencë punësimi për shkak të mbarimit të masterit.

transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Evidenca: <i>Shtojca 2.7- Pogramet lendore te prgramit te studimit Shtojca 2.4- Rregullore e programit të studimit "Master i profesional" në 'Infermieristikë' Shtojca 4.4- Tabela 21 e të dhënave të regjistrimit, ecurisë dhe viteve akademike (mesatarja në hyrje dhe dalje)</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me studentët;</i>
Kriteri 5. Syllabusët (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	GVJ vëren që nuk plotësohet plotësisht, ka disa mangësi në literature, nuk paraqiten tematikat me literature sipas faqeve dhe nuk ka një "journey/praktike pune/kontroll" të syllabusit nga lektori deri tek Drejtoria e kurrikulave apo NJSBC. Evidenca: <i>Shtojca 2.4- Rregullore e programit të studimit "Master i profesional" në 'Infermieristikë' Shtojca 2.3- Rregullore e njësisë bazë Shtojca 2.7- Pogramet lendore te prgramit te studimit</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me përfaqësues të Komisionit për Kurrikulat</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Sipas insitucionit përmbajtja e programit të studimit i shërben rritjes së kapaciteteve profesionale në fushën e Infermierisë, aftësimi profesional teorik dhe praktik në zgjidhjen e situatave të ndryshme klinike dhe në kryerjen e procedurave të sakta. GVJ e gjykon te nevojshme të riformatohen rezultatet e të nxëniet të studentit. Sugjerohet të shtohen: 1. Gjykim dhe arsyetim Klinik i avancuar; 2. Aftësitë e Lidërsipit dhe Menaxhimit; 3. Praktika e Bazuar në Prova; 4. Komunikimi dhe aftësitë ndërpersonale; 5. Përmirësimi i cilësisë dhe siguria; 6. Avokimi dhe Kujdesi i Përqendruar te Pacienti Evidenca: <i>Shtojca 2.4- Rregullore e programit të studimit "Master i profesional" në 'Infermieristikë'</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë.</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e	Nuk paraqitet në të dhëna nga ALUMNI të këtij programi per

programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	studentet qe janë të punësuar. Gjithashti GVJ evidenton që nuk ka vijëmësi të vazhdimit të studimeve në programin master shkencor në infermieri. Evidenca: <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë; Takim me studentët.</i>
Konkluzione	GVJ pas evidentimit të evidencave dhe takimeve me stafin nuk parashtruan një evidencë në lidhje me alumni dhe kompetencat e fituara nga masteri profesional në infermieristikë. Nuk ka të dhëna për Alumni mbi punësimin nga Urdhërat profesionale apo dhe sektori alumni në Universitet. Organizimi i lëndëve në semestra është bërë duke u bazuar në ligjin për arsimin e lartë, si dhe në udhëzimet përkatëse. Ajo që vërehet është tek objektivat formues ka një mos rakordim të disiplinave si psh gjuhës huaj ku thuhet që është lëndë plotësuese ndërsa në kurrikulë është lëndë ndërdisiplinore. Rekomandohet riorganizim mbi 20% të kurrikulës. GVJ evidenton që nuk paraqitet ndonjë evidencë që janë programe të ngjashme me ato ndërkombetare dhe raporti teori praktike nuk është sipas vendim nr 823. Aktualisht paraqitet raporti 2:1 teori/praktikë. Duhet hequr togfjalëshi Praktikë Institucionale me Praktike Profesionale ose klinike. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë jo mjaftueshëm arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. GVJ evidentoi dhe në takime me stafin dhe studentët qe nuk ka mundësi mobiliteti apo evidencë punësimi për shkak të mbarimit të masterit. GVJ vëren që nuk plotësohet plotësisht, ka disa mangësi në literature, nuk paraqiten tematikat me literature sipas faqeve dhe nuk ka një “journey/praktike pune/kontroll” të syllabusit nga lektori deri tek Drejtorja e kurrikulave apo NJSBC. Nuk paraqitet të dhëna nga ALUMNI të këtij programi për studentet qe janë të punësuar. Gjithashti GVJ evidenton që nuk ka vijëmësi të vazhdimit të studimeve në programin master shkencor në infermieri.
Shkalla e përmbushjes së	Nuk Përmbushet Përmbushet Përmbushet Përmbushet

standardit	permbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Nuk paraqitet ndonjë evidencë në lidhje me këtë kriter. Pra nuk kemi një raport të shkruar apo një propozim nga aktorët e përmendur në këtë kriter. Evidenca: <i>Shtojca 2.2- Rregullore e DI</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Sipas raporteve të NJSBC ka mangësi në plotësimin e kriterit 2. FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS DHE SHKENCAVE HUMANË Nuk kemi të dhëna për këtë fakultet pasi nuk është dorëzuar RVB e fakultetit Sektori i Kurrikulës Vlerësimi Institucional dhe Alumni Evis Kapurani Evidenca: <i>Shtojca 1.2.4-Manual per vleresimin e performances se stafit akademik</i> <i>Shtojca 3.6- Raportet vjetore të NJSBC</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me	Rishikimi i programit është bërë vetëm për të ndryshuar nga 90 kredite në 60 kredite. Nuk evidentohet që të plotësohet ky kriter, pavarësisht ndryshimit të emertesës së një lënde.

propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Evidenca: <i>Shtojca 2.9-Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik.</i>		
KONKLUZIONE	Nuk paraqitet ndonjë evidencë në lidhje me kriterin 1. Pra nuk kemi një raport të shkruar apo një propozim nga aktorët e përmendur në këtë kriter. Sipas raporteve të NJSBC ka mangësi në plotësimin e kriterit 2. Rishikimi i programit është bërë vetëm për të ndryshuar nga 90 kredite në 60 kredite. Nuk evidentohet që të plotësohet ky kriter, pavarësisht ndryshimit të emertesës së një lënde.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi i studimit 'Master Profesional' në "Infermieristikë" nga ana kërkimore-shkencore paraqitet dobët në evidenca në raport me UNIKO. Nga ana e stafit u evidentua që nuk ka artikuj në scopus dhe conference në njësine e tyre në fushën mjeksore. Gjithashtu evidentuar dhe nga syllabuset, por dhe nga pyetja e studenteve nuk angazhohen studentet në kërkim shkencor. Evidenca: <i>Shtojca 1.1- Statuti I UNIKO Shtojca 1.2 - Rregullore e UNIKO</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike	Njësia bazë, Departamenti i Infermierisë, luan një rol aktiv në bashkërendimin dhe administrimin e veprimtarive të mësimdhënies, por UNIKO duhet të bëjë me shumë në lidhje me financimin e veprimtarisë kërkimore të stafit. Evidenca:

të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	<i>Shtojca 3.7- Analiza vjetore e veprimtarisë së Njesisë Bazë</i> <i>Shtojca 4.8 - Tabela e të dhënave për kualifikimin dhe kërkimin shkencor</i>			
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Programi i studimit 'Master Profesional' në 'Infermieristikë', përveç aktiviteteve sensibilizuese si diabeti, dhurimi gjakut, nuk paraqet aktivitete kërkimore shkencor të studenteve në projekte apo konferenca të ndryshme. Evidenca: <i>Shtojca 3.2.3 - Dosje e leksioneve/aktiviteteve/konferencave të hapura</i>			
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Nuk paraqitet një aktivitet i tillë në lidhje me rimbursimin apo mbështetjen për artikuj apo projekte në drejtim të programit master. Evidenca: <i>Shtojca 3.7- Analiza vjetore e veprimtarisë së Njesisë Bazë</i> <i>Shtojca 2.1.6- Vendim i Bordit të Administrimit dhe Senatit të UNIKO për financimin e kërkimit shkencor</i>			
Konkluzione	Programi i studimit 'Master Profesional' në "Infermieristikë" nga ana kërkimore-shkencore paraqitet dobët në evidenca në raport me UNIKO. Njësia bazë, Departamenti i Infermierisë, luan një rol aktiv në bashkërendimin dhe administrimin e veprimtarive të mësimdhënies por UNIKO duhet të bëjë më shumë në lidhje me financimin e veprimtarisë kërkimore të stafit. Programi i studimit 'Master Profesional' në 'Infermieristikë', përveç aktiviteteve sensibilizuese si diabeti, dhurimi gjakut, nuk paraqet aktivitete kërkimore shkencor të studenteve në projekte apo konferenca të ndryshme. Nuk paraqitet një aktivitet i tillë në lidhje me rimbursimin apo mbështetjen për artikuj apo projekte në drejtim të programit master.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim

shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Nuk ka projekte kërkimore në fushën e masterit. <i>Evidenca:</i> <i>Shtojca 1.2.3 - Rregullore e drejtorisë së projekteve dhe kërimit shkencor Shtojca 1.3 - Plan i strategjik i zhvillimit të uniko 2022-2027;</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Nuk ka evidencë në analizën vjetore të njësisë bazë për këtë kriter. <i>Evidenca:</i> <i>Shtojca 3.7- Analiza vjetore e veprimtarisë së Njësisë Bazë Shtojca 4.8 - Tabela e të dhënave për kualifikimin dhe kërkimin shkencor Shtojca 3.2.3 - Dosje e leksioneve/aktiviteteve/konferencave të hapura</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Përveç aktiviteteve sensibilizues, DI nuk ka bërë një konferencë që ndihmojnë personelin dhe studentët në ndihmë të programit. <i>Evidenca:</i> <i>Shtojca 3.7- Analiza vjetore e veprimtarisë së Njësisë Bazë Shtojca 4.8 - Tabela e të dhënave për kualifikimin dhe kërkimin shkencor</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi i studimit sipas Institucionit, bazuar në objektivat dhe misionin e tij, synon rritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e Infermieristikës dhe përgatitjen e infermierëve me kompetenca dhe aftësi të shtuara profesionale, me qëllim përballimin e sfidave që ata mund të ndeshin në vendet ku do të punojnë. Por GVJ në takimin me stafin dhe drejtuesit evidentoi që nuk ka një evidencë në lidhje me këtë kriter që formojnë profesionistë konkurrues. <i>Evidenca:</i> <i>Shtojca 2.4- Rregullore e programit të studimit "Master i profesional" në "Infermieristikë" Shtojca 1.3 - Plan i strategjik i zhvillimit të uniko 2022-2027;</i>

Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Nuk ka evidencë të paraqitur nga institucioni për këtë kriter. Evidenca: <i>Shtojca 2.9- Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale</i>			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Programi i studimit 'Master Profesional' në 'Infermieristikë' nuk përputhet me aktet ligjore, direktivat dhe rekomandimet e Bashkimit Evropian për profesionet e rregulluara. Kjo vjen dhe si pasojë e kufizimeve të VKM nr 41. Shtojca 5.23 - Per miratimin e listes kombetare te profesioneve (LKP), te rishikuara https://www.akafp.gov.al/epcontent/uploads/2022/12/vendim-2017-09-20-514.pdf			
Konkluzione	Nuk ka projekte kërkimore në fushën e masterit. Nuk ka evidencë në analizën vjetore të njësisë bazë për kriterin 2. Përveç aktiviteteve sensibilizues, DI nuk ka bërë një konferencë që ndihmojnë personelin dhe studentët në ndihmë të programit. GUVJ në takimin me stafin dhe drejtuesit evidentoi që nuk ka një evidencë në lidhje me kriterin 4 që formojnë profesioniste konkurrues. Nuk ka evidencë të paraqitur nga institucioni kriterin 5.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht X	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht X	Përmbushet plotësisht
--	--	------------------------------	---	------------------------------

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Sipas Rregullores së Institucionit, Rregullores së Njesisë Kryesore dhe Rregullores së programit të studimit, përcakton format e mësimdhënies. Ato janë leksionet, seminarët, praktikat profesionale, detyrat e kursit, laboratorët etj. Programi i studimit është i strukturuar duke përfshirë një gamë të gjerë metodash mësimdhënieje, si leksione, seminare, laboratorë, praktika profesionale dhe klinike, përgatitjen e detyrave të kursit, tema diplome, punë kërkimore në laborator, si dhe leksione të hapura të organizuara nga departamenti. Institucioni inkurajon gjithashtu pjesëmarrjen e studentëve në konferenca, trajnime dhe workshope, duke nxitur zhvillimin akademik dhe profesional të tyre. Evidenca: <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët;</i> <i>Takim me përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave.</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Sipas stafeve personeli akademik përdor një gamë të gjerë metodash alternative të mësimdhënies për të siguruar zhvillimin e procesit mësimor në mënyrë sa më të përshtatshme për studentët. Metodatat e përdorura përfshijnë PowerPoint, figura, video, bashkëbisedim, raste klinike dhe teknika të tjera, të cilat synojnë ta bëjnë mësimin më interesant dhe interaktiv. Këto metoda janë të konfirmuara nga studentët, të cilët i kanë vlerësuar ato si efektive në përmirësimin e angazhimit dhe kuptimit të materialeve mësimore. Në kuadër të plotësimit të kriterit 2 GVJ rekomandon të pasqyrohen në syllabus format mesimore si psh raste klinike

	apo forma te tjera apo: 1. Mësimi i Bazuar në Projekte (Project-Based Learning - PBL) 2. Mësimi i Flipped Classroom (Klasa e Anasjelltë) 3. Mësimi i Bazuar në Simulime dhe Laborator Virtual 4. Gamifikimi në Procesin e Mësimdhënies 5. Mësimi i Asistuar nga Inteligjenca Artificiale 6. Mësimi i Bazuar në Studime Rasti Evidenca: <i>Shtojca 2.4 Rregulloren e Programit te studimit</i> <i>Shtojca 2.7 Programet lëndore të programit të studimit</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	GVJ evidenton se nuk ka trajnime apo manuale të mësimdhënies që ndihmojnë pedagogun dhe studentin në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Evidenca: https://innovativeteachingideas.com/blog/a-teachers-guide-to-blooms-taxonomy/?srsltid=AfmBOoqDLRqëvvZEZU-DG_fvGxd9E85ioEAY9mrbC-UHUbBtF9ijBbYS https://sëu.phinma.edu.ph/ëp-content/uploads/2021/05/Nurse-as-Educator-Principles-of-Teaching-and-Learning-for-Nursing-Practice-by-Susan-B.-Bastable-z-lib.org_.pdf <i>Shtojca 3.7 Raportet e Analizës së Punës Vjetore,</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;</i> <i>Takim me përfaqësuesit e Komisionit për Kurrikulat dhe Mësimin</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë	Gjatë takimeve me autoritetet drejtuese dhe Burimet Njerëzore, u raportua se UK përpaket të rekrutojë staf me eksperiencë të mjaftueshme në mësimdhënie. Por GVJ evidenton që nuk janë të pasqyruar në syllabus format mësimore si psh raste klinike apo forma të tjera. Evidenca: <i>CV e Personelit akademik i angazhuar në mësimdhënie ku</i>

kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	<i>pershtrihen dhe kompetencat në mësimdhënie.</i> <i>Shtojca 3.25 Raportet e Analizës së Punës Vjetore DI, Shtojca 3.13Raporti i Performancës së stafi akademik.</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët;</i> <i>Takim me përfaqësues të Burimeve Njëerëzore.</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	GVJ evidenton që ka pyetësor për studentët, por rekomandohet që të zhvillohet në nivel programi një analize e tillë. Evidenca: <i>Shtojca 3.12 Pyetsor studentor/raport</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët;</i> <i>Takim me përfaqësuesit e Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave.</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	GVJ evidenton se nuk ka trajnime apo manuale të mësimdhënies që ndihmojnë pedagogun dhe studentin në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Evidenca: <i>3 Organigrama UNIKO;</i> <i>Evidenca 186. Vendimi i Bordit të Akreditimit, ASCAL.</i> <i>Evidenca 169 Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Institucional _UNIKO_Maj 2022</i> <i>Takim me përfaqësuesit e Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave.</i>
Konkluzione	Në kuadër të plotësimit të kriterit 2 GVJ rekomandon të pasqyrohen në syllabus format mësimore si psh raste klinike

	apo forma te tjera apo: 1. Mësimi i Bazuar në Projekte (Project-Based Learning - PBL) 2. Mësimi i Flipped Classroom (Klasa e Anasjelltë) 3. Mësimi i Bazuar në Simulime dhe Laborator Virtual 4. Gamifikimi në Procesin e Mësimdhënies 5. Mësimi i Asistuar nga Inteligjenca Artificiale 6. Mësimi i Bazuar në Studime Rasti GVJ evidenton se nuk ka trajnime apo manuale të mësimdhënies që ndihmojnë pedagogun dhe studentin në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. GVJ evidenton që nuk janë të pasqyruar në syllabus format mesimore si psh raste klinike apo forma të tjera. GVJ evidenton që ka pyetësor për studentët, por rekomandohet që të zhvillohet në nivel programi një analize e tillë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Institucioni ka një bazë ligjore të plotë që rregullon organizimin e provimeve dhe vlerësimin e njohurive të studentëve, të cilat janë të njohura dhe të disponueshme për studentët që në fillim të vitit akademik. Rregullorja e programit të studimit dhe rregulloret e përgjithshme të institucionit përcaktojnë qartë modalitetet e testimit të njohurive. Në syllabuset e lëndëve pasqyrohen format e kontrollit të njohurive. Për disa vjet, Departamenti i Infermierisë përdor sistemin automatizuar CLEANSORE për korrigjimin e provimeve, i financuar nga AADF. Sipas Nenit 63 të Rregullores së institucionit, Rregullorja e Njesisë Kryesore dhe Rregullorja e Programit të studimit përcaktojnë kriteret dhe metodat e testimit dhe vlerësimit të njohurive.

	Vlerësimi i studentëve bazohet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është një kombinim i elementëve të mëposhtëm: 1. Provimi përfundimtar 70 % 2. Vlerësimi i vazhduar 30 % - Ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive 10% - Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit) 5 – 10 % - Testimet gjatë vitit 10 – 15 % Evidenca: <i>Shtojca 2.7 Programet lëndore të programit të studimit</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në fillim të çdo moduli, pedagogu informon studentët mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, informacion që është gjithashtu i dokumentuar në syllabuset përkatëse të lëndëve. Ky informacion është konfirmuar si nga stafi akademik, ashtu edhe nga studentët gjatë takimeve. Procedura e vlerësimit është e qartë dhe transparente, dhe studentët janë të informuar për detyrimet që kanë në përfundim të lëndës/modulit. Evidenca: <i>Shtojca 2.7 Programet lëndore të programit të studimit</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Sipas Kreut IV të Rregullores së Njesisë Kryesore dhe sipas pikës 16 të Rregullores së programit të studimit, kontrolli i dijes së një lënde bëhet me cikle (module dhe provime). Kontrolli i dijes, si rregull, bëhet me dorëzim projektsh, detyrash, me provim me shkrim, me gojë, me praktikë ose i kombinuar me shkrim dhe me gojë. <i>GVJ rekomandon që të përmirësohet infrastruktura laboratorike për të bërë testimin e njohurive praktike.</i>

	Evidenca: <i>Shtojca 2.4 Rregullorja e programit të studimit</i> <i>Shtojca 2.7 Programet lëndore të programit të studimit</i>			
Konkluzione	GVJ rekomandon që të përmirësohet infrastruktura laboratorike për të bërë testimin e njohurive praktike. GVJ e konsideron këtë një praktikë të mirë që UK duhet të vazhdojë ta ndjekë por rekomandon që pyetësi të realizohet në nivel programi, duke qënë se dhe njësia kryesore nuk është në profilin e shkencave të shëndetit dhe mjeksore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.3 Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në rregulloren e Programit të studimit raportohet se vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm dhe në syllabuse raportohet se nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm: 1. Provimi përfundimtar 70 % 2. Vlerësimi i vazhduar 30 % - Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive 10% - Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit) 5 – 10 % - Testimet gjatë vitit 10 – 15 % Të gjitha mënyrat dhe elementet e vlerësimit janë të parashikuara në syllabuse dhe rregullore, të cilat prezantohen edhe nga titullari i lëndës.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Institucioni prej disa vitesh ka vënë në përdorim platformën e korrigjimit të provimeve Clean Score në bashkëpunim me AADF. Projekti zbatohet prej disa vitesh në institucione publike dhe jo-publike të arsimit të lartë. Me qëllim që vlerësimi të jetë i drejtë dhe i paanshëm, në të gjitha provimet e programit MP në “Infermieristike” përdoret korrigjimi i tezave me sistemin

	Clean-score. Rezultatet jepen në kohë reale, ndërsa notat publikohen brenda afateve të përcaktuara nga rregullorja përmes sistemit Pitagora. Evidenca: <i>Shtojca 3.15 Raporti i implementimit Sistemi CLEAN- SCORE</i> <i>Shtojca 1.6.1 Manual i sistemit elektronik PITAGORA</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Testimi përfundimtar i lëndës realizohet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi, dhe mund të jetë i shkruar, me gojë ose i kombinuar, në varësi të lëndës. Provimi është i mbikëqyrur nga një komision i përbërë nga dy pedagogë, të cilët janë të pranishëm gjatë zhvillimit të tij, në përputhje me numrin e studentëve dhe sallën në dispozicion. Teza e provimit hartohet nga pedagogu që ka zhvilluar leksionet, kontrollohet nga titullari i lëndës dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit. Në syllabuset e lëndëve janë përcaktuar detyrimet e studentëve, duke përfshirë mënyrën e vlerësimit të vazhduar, raportet e vlerësimit, detyrat e kursit, laboratorët dhe frekuentimin. Studentët informohen gjithashtu për temat që do të mbulohen në provim, formatin e pyetjeve dhe materialet që do të përdoren gjatë lëndës. GVJ u njoh me formatin e fletës së provimit dhe procedurën e ndjekur për hartimin, korrigjimin dhe vlerësimin përfundimtar. Evidenca: <i>Shtojca 1.1 Statusi i Universitetit Fan S. Noli</i> <i>Shtojca 1.2 Rregullore e UNIKO</i> <i>Shtojca 2.4 Rregullorja e programit të studimit Shtojca 2.7 Programet lëndore të programit të studimit</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/fëdback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të	Studenti hyn në provim pasi ka kryer detyrimet e procesit mësimor për çdo lëndë dhe detyrimet financiare sipas kontratës që ka me institucionin. Në rregullore përcaktohen qartë detyrimet që lidhen jo vetëm me ndjekjen e procesit mësimor por dhe me numrin e ECTS-ve teoriko-praktike dhe llojin e lëndëve që studenti duhet të ketë të plotësuar para futjes në një sezon provimi. Kur provimi kryhet me gojë vlerësimi shoqërohet me komente dhe këshillime të studentit për

ardhmen.	performancën e arritur në provim. Ndërsa në provimet me shkrim komentet dhe sugjerimet kryhen në seancën e komunikimit të rezultateve. Në këto seanca pedagogu i mundëson studentit, nëse dëshiron, të shikojë rezultatet e provimit, bazuar në Rregulloren e UK, Rregulloren e FSHNH dhe Rregulloren e Programit të studimit. Në përfundimin e provimeve, studentët informohen për rezultatet e provimit në sistemin Pitagora. Evidenca: <i>Shtojca 2.4 Rregullorja e programit të studimit</i> <i>Shtojca 2.7 Programet lëndore të programit të studimit</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Përdorimi i materialeve të ndaluara, kopjimi dhe veprime të tjera të tilla nuk lejohen. Në syllabuset e lëndëve është përcaktuar kodi i etikës, ku detajohen veprimet që janë të ndaluara për studentët, duke përfshirë kopjimin dhe plagjiaturën. Komisioni i provimeve siguron transparencë maksimale dhe nuk lejon asnjë abuzim nga studentët, duke parandaluar kopjimin dhe çdo formë tjetër që mund të deformatë vlerësimin e drejtë që secili student meriton. Për punimet e detyrave të kursit dhe diplomave, aplikohen verifikime nëpërmjet programeve antiplagjiaturë. Evidenca: <i>Shtojca 21.2 Neni 83 dhe 95 sipas Rregulloreve të UNIKO.</i> <i>Shtojca 2.4 Rregullore e programit të studimit MP Infermieristike</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Studentët informohen mbi rezultatet e provimeve brenda afateve ligjore të përcaktuara nga Rregullorja e programit të studimit. Korrigjimi i provimeve bëhet me sistemin Cleanscore, i cili kodifikon automatikisht rezultatet 30-60 minuta pas mbarimit të provimit. Rezultatet publikohen menjëherë online në faqen përkatëse https://cleanscore.al/arkiva. <i>Kjo është një procedurë shumë e rëndësishme dhe një pikë e fortë e këtij programi studimi.</i> Korrigjimi i provimit me shkrim bëhet nga komisioni i provimeve, dhe rezultatet u bëhen të njohura studentëve brenda afatit të përcaktuar. Komisioni cakton një ditë për dhënien e

	rezultateve dhe shqyrtimin e ankesave lidhur me vlerësimin. Studentët shprehen të kënaqur me procedurën e vlerësimit dhe kanë deklaruar se vlerësimi është i drejtë dhe në përputhje me rregulloren e provimeve. Rezultatet e provimeve u komunikohen studentëve në mënyrë konfidenciale përmes llogarisë së tyre personale në sistemin Pitagora. Studentët kanë të drejtën e ankimit, i cili parashikohet dhe rregullohet nga rregullorja, dhe shqyrtohet nga komisioni përkatës i ngritur nga njësia përgjegjëse. Procesi mbyllet me dorëzimin e fletës së notave në sekretari. Gjithashtu, studenti ka të drejtën të kërkojë rishikimin e notës.
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studentët kanë të drejtën të njihen me rezultatet e vlerësimit, të informohen për gabimet e tyre në provim, si dhe kanë mundësinë të kontestojnë vlerësimin në rast se nuk janë dakord me të. Ata kanë të drejtën të njihen me pikët e vlerësimit të tezës, sipas nenit 85 të Rregullorës së UK. Në rast se janë shkelur rregullat proceduriale gjatë zhvillimit të provimit ose nëse ndjehen të vlerësuar padrejtësisht, studentët mund të ankohen. Ankesa duhet të bëhet me shkrim brenda ditës së marrjes së rezultatit për provimin me gojë dhe jo më vonë se 8 ditë pas dhënies së rezultatit për provimin me shkrim. Ankesa duhet të drejtohet tek Dekani i Fakultetit, i cili vlerëson nëse ankesa është e drejtë dhe ia përcjell për shqyrtim departamentit përkatës. Kjo e drejtë për ankesa është e parashikuar në rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit, duke mundësuar që studenti të njihet me vlerësimin, të ankimohet për të dhe të mund të përmirësojë notën përmes riprovimit.
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Sipas nenit 83 të Rregullorës së UK, çdo ankimim për vlerësim shqyrtohet pasi kalon nga përgjegjësi i departamentit dhe dërgohet te Dekani i Fakultetit. Dekani, me propozim nga Përgjegjësi i Departamentit, vendos për ndryshimin e komisionit të provimit dhe mund të caktojë ridhënien e provimit brenda ditës ose të nesërmen pas përfundimit të tij. Komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezën e zgjidhur. Nëse studenti

	nuk është i kënaqur me sqarimin e komisionit, ai ka të drejtën të kërkojë rishikim të testit nga një komision tjetër, i cili ngrihet me propozim të përgjegjësit të departamentit dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit, pasi analizon pretendimet dhe argumentet e studentit. Pas këtij afati, nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni është i detyruar të bëjë mbylljen përfundimtare të procesverbalit në sistem dhe në sekretarinë mësimore. Studentit i vihet në dispozicion rregullorja e programit të studimit, e cila përshkruan procedurën e ankimimit. Për çdo sqarim të mëtejshëm, studenti mund t'i drejtohet koordinatorit të programit ose përgjegjësit të departamentit deri në sqarimin e çdo problematike që mund të ketë.			
KONKLUZIONE	<i>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Mënyra e vlerësimit është e parashikuar në syllabuset e lëndëve/moduleve. Testimi përfundimtar i lëndës realizohet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Provimi realizohet me shkrim, me gojë ose i kombinuar. Studentët kanë të drejtën e ankimimit të rezultatit nëse kanë pakënaqësi apo paqartësi të lidhura me vlerësimin. Kjo e drejtë sanksionohet në rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit. Vlerësimi bazohet në meritë. FSHNH ka krijuar mekanizma për të luftuar plagjiaturën dhe kopjimin në provime.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta	GVJ evidenton që programi duhet të përafrohet me “ VENDIM Nr. 823, datë 28.12.2023: PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 41, DATË 24.1.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ELEMENTËT E

shkencore të studentëve.	PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË”, TË NDRYSHUAR”. Gjithashtu duhet të shtohen kurset e infermieristikave. Evidenca: <i>Shtojca 2.6 Plani mesimor MP Infermieristike vitet 2022-2023 dhe 2023-2024.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Plani mësimor i programit "Master Profesional në Infermieristike përmban një lëndë " Teknologji informacioni të aplikuara në shëndetsi" e cila u mundëson studentëve përdorimin e softëareve për organizimin dhe mbajtjen e një sistemi të informacionit. Lënda parashikohet të zhvillohet në laboratorë të pajisur me pajisjet dhe programet përkatëse kompjuterike. [Referenca: shtojca 2.6 plani mësimor.pdf: shtojca 2.7 programi lëndor.pdf] Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e komunikimi dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj) sepse përmban lëndë si "Gjuhë e huaj për qëllime specifike".
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Në fund të lëndës, pedagogët informojnë dhe orientojnë studentët për çështjet më të rëndësishme. Stafi akademik raportoi se zhvillon konsultime me studentët në orën e fundit të lëndës. Në javën e fundit të semestrit studentët orientohen në lidhje me strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë provimi final dhe gjithashtu edhe për peshën që do të ketë në notën finale të modulit provimi final. Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit bachelor "Mami" integron të rejtat më të fundit të shkencës dhe teknologjisë së informacionit që ju jepet studentëve gjatë orarit normal të zhvillimit të modulit dhe jashtë tij kur është e nevojshme. Në fund të praktikës klinike dhe profesionale pedagogu analizon dhe vlerëson aftësitë profesionale të fituara nga studentët. Institucioni ka hartuar një raport vjetor, që plotëson stafi akademik në fund të semestrit dhe ku specifikohen objektivat e arritura, literatura e përdorur, frekuentimi, realizimi i programit etj. <i>Kjo është një procedurë shumë e rëndësishme dhe GVJ e konsideron se pikë të fortë.</i> Studentët raportuan se zhvillojnë konsultime me pedagogët.

	Evidenca: <i>Shtojca 2.6 plani mësimor.;</i> <i>Shtojca 2.7 programi lëndor.</i> <i>Shtojca 2.4 rregullorja e Programit te studimit.</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	GVJ evidentoi që edhe gjatë vizitës dhe dokumentacionit të përcjellur labororet ishin të pamjaftueshmë në pajisje për të siguruar praktika për studentet e Masterit. Evidenca: <i>Shtojca 2.7 Programet lëndore dhe në vecanti "Praktika profesionale institucionale" përshkruajnë me detaje objektivat e të nxënësve dhe kompetencat.</i>
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Në kriterin 5 GVJ eidenton që përveç aktiviteteve në kuadër të sensibilizimit të diabetit apo autizmit, nuk paraqitet një evidencë që të plotësohet ky kriter.
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Nuk plotësohet kriter 6.
KONKLUZIONE	GVJ eidenton që programi duhet të përafrohet me " VENDIM Nr. 823, datë 28.12.2023: PËR DISA SHITESA DHE

	NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 41, DATË 24.1.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË", TË NDRYSHUAR". Gjithashtu duhet të shtohen kurset e infermieristikave. GVJ evidentoi që edhe gjatë vizitës dhe dokumentacionit të përcjellur laboratorët ishin të pamjaftueshmë në pajisje për të siguruar praktika për studentet e MP-së. Në kriterin 5 GVJ evidenton që përveç aktiviteteve në kuadër të sensibilizimit të diabetit apo autizmit, nuk paraqitet një evidencë që të plotësohet ky kriter.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Diplomimi i studentit (bazuar në Neni 90, i Rregullores së Përgjithshme të Universitetit —Fan S. Nolit, Korçë). Në përfundim të studimeve, nga çdo student i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë: —Master Profesional në —Infermieristikë, do të bëhet mbrojtja e diplomës me anë të Punimit të Diplomës. Studenti nuk lejohet të mbrojë Temën e Diplomës apo të japë Provimin Përfundimtar, në qoftë se nuk ka shlyer më parë të gjitha detyrimet (nuk ka marrë nota kaluese në të gjitha provimet e disiplinave të Programit të Studimit). Kjo bazohet nga Neni 73, pika 2, e Ligjit Nr. 80/2015, —Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë. Tipologjitë e Temave të Diplomës. Fushat e mundshme të studimit për realizimin e Punimit të Diplomës. Evidenca: <i>Shtojca 2.4 Rregullore e programit të studimit</i>

Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	<i>Shtojca 2.12 Manual për Punimin E Temës Së Diplomës</i> Sipas Neni 90 të Rregullores së UNIKO, studentët në programet e ciklit të parë të studimeve diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar. Neni 70, pika 3 e Statutit të UNIKO përcakton që në përfundim të programeve të ciklit të parë lëshohet diploma “Bachelor” në fushën e arsimimit të kryer. Modalitetet e zhvillimit të provimit final jepen në aktet e brendshme të institucionit dhe për të fituar të drejtën e hyrjes në provimin përfundimtar studenti duhet të ketë marrë vlerësime pozitive në të gjitha lëndët mësimore dhe në praktikë duke marrë kreditet e nevojshme. Diplomimi realizohet në sezone dhe për studentët që nuk diplomohen në sezonin e diplomimit të verës mund të diplomohen në sezonin pasardhës të vjeshtës. Pedagogu mbështetet në Manualin e Hartimit të Temës së Diplomës për procesin e hartimit të temës, duke udhëzuar studentin mbi strukturën, metodologjinë dhe kërkesat akademike që duhen ndjekur. Ky manual shërben si udhëzues për të siguruar një punim shkencor të rregullt dhe në përputhje me standardet e institucionit. <i>Evidenca:</i> <i>Shtojca 2.4 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Shtojca 2.12 Manual për Punimin E Temës Së Diplomës</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	GVJ evidenton që nuk ka evidencë se cilat grup lëndë janë të përfshira në provim e diplomimit. <i>Evidenca:</i> <i>Shtojca 2.12 Manual për Punimin E Temës Së Diplomës</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve,	Po Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Ai asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.

përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Evidenca: <i>Shtojca 2.4 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Shtojca 2.12 Manual për Punimin E Temës Së Diplomës</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	GVJ evidenton që nuk paraqitet ndonjë evidencë që ndonjë nga lektorët ndihmon studentët në realizimin e pyetësoreve apo matjeve të ndryshme për qëllime studimore të studentëve. Evidenca: <i>Shtojca 2.9 Marreveshje bashkepunimi me Spitalin Rajonal etj</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë nga anëtarët e komisionit përkatës. Pas vlerësimit, procesverbali dorëzohet në sektorin e studimeve dhe sektorin e TIK, i firmosur nga anëtarët dhe kryetari i komisionit. Korrigjimi i provimit kryhet në mënyrë anonime, pa kodim të identitetit të studentit. Pas përfundimit të korrigjimit, sekretaria përpilon dhe publikon rezultatet, duke siguruar transparencë dhe saktësi në vlerësim. Evidenca: <i>Shtojca 1.2 Rregullore e Universitetit Fan S. Noli, Korçë</i> <i>Shtojca 2.4 Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, studentët pajisen me diplomën përkatëse dhe suplementin e diplomës, sipas parashikimeve të nenit 70, pika 3 të Statutit të Universitetit "Fan S. Noli" dhe Nenit 90 të Rregullores së programit të studimit. Përveç diplomës dhe suplementit, studentët marrin një kopje të programit të studimit që kanë përfunduar në ciklin e parë të studimeve (Bachelor). Kopjet e dokumenteve të studentëve ruhen në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke siguruar mbrojtjen e të dhënave personale dhe akademike. Informacioni mbi studentët, përfshirë regjistrin themeltar dhe regjistrin e arritjeve akademike,

	plotësohet dhe ruhet sipas procedurave dhe rregullave të përcaktuara nga legjislatura dhe politika e institucionit. Evidenca: <i>Shtojca 2.5 Modeli i diplomës/ Suplementit të programit të studimit.</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Dokumentacioni i studentëve për periudhën e studimeve, nga hyrja deri në përfundim, mbahet, përpunohet dhe ruhet sipas rregullave dhe procedurave përkatëse. Ky proces siguron mundësinë e shërbimit të shpejtë për kërkesat e studentëve, siç janë transferimi i studimeve, hartimi i vërtetimeve, listave të notave dhe dokumenteve të tjera të nevojshme. Diplomat e studentëve regjistrohen në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, që mbahet në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve. Kjo siguron që informacioni mbi diplomimin e studentëve është i dokumentuar dhe i njohur në nivel shtetëror. Për sa i përket ruajtjes së dokumentacionit, kopjet e tij ruhen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe janë të disponueshme për studentët, sipas kërkesës, përmes sekretarisë mësimore. Informacioni mbi studentët (regjistri themeltar, regjistri i arritjeve akademike) ju vu GVJ në dispozicion nga sekretaria mësimore gjatë vizitës në institucion. Evidenca: <i>Shtojca 2.2 Rregullorja E Njësisë Kryesore.</i>
Konkluzione	<i>Procesi i diplomimit realizohet me anë të provimit përfundimtar të formimit, në përfundim të vitit të tretë akademik, Provimi i diplomës bëhet në dy sesione diplomimi të cilat përcaktohen nga Dekani i Fakultetit. Studenti që nuk paraqitet ose vlerësohet negativisht në sesionin e parë të provimeve, ka të drejte të paraqitet në provim në sesionin e ardhshëm. Departamenti përcakton datën e zhvillimit të provimit të diplomes. Detyrimet përmbyllëse kanë në total 17 kredite. Studentët kanë mundësi të përdorin kapacitetet dhe infrastrukturën e UK, për arsye kërkimore. Në përfundim të studimeve, studentët pajisen me diplomën dhe suplementin e</i>

	<i>diplomës.</i> GVJ evidenton që nuk ka evidencë se cilat grup lëndë janë të përfshira në provim e diplomimit. GVJ evidenton që nuk paraqitet ndonjë evidencë që ndonjë nga lektoret ndihmon studentët në realizimin e pyetësoreve apo matjeve të ndryshme për qëllime studimore të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	GVJ rekomandon që të përmirësohet infrastruktura laboratorike për të bërë testimin e njohurive praktike. Shtojca 2.7 Programe lëndore të programit të studimit
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	GVJ rekomandon që të përmirësohet infrastruktura laboratorike për të bërë testimin e njohurive praktike.
Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në	Praktikat profesionale, klinike dhe praktikrat institucionale e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe note. Evidenca:

kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Shtojca 2.9 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale			
KONKLUSIONE	GVJ rekomandon që të përmirësohet infrastruktura laboratorike për të bërë testimin e njohurive praktike. Nuk ka evidenca si ndahen studentet në grafike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në	Personeli akademik që mbulon programin e studimit “Master Profesional” në “Infermieristikë” në Departamentin e Infermierisë pranë FSHNH përbëhet nga pedagogë me eksperiencë dhe përgjithësisht kualifikimin e duhur profesional në fushat përkatëse që ata zhvillojnë në program. Nga shyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, departamenti për vitin 2024-2025 ka në përbërjen e tij 12 pedagogë me kohë të plotë (PAE), nga këta 5 me gradën Dr dhe 7 (shtatë) Msc. Numri i personelit akademik me kohë të plotë është i qëndrueshëm në vite. Kualifikimi i tyre me Grada dhe Tituj duhet përmirësuar.

mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Nga GVJ evidentohet që ka një numër më të madhe lektorësh që janë me profesion mjek sesa infermier, kjo dhe në bazë të kurrikulës që është hartuar dhe nuk drejtohet drejt profesionit të infermierit.

Për tre vite akademike të dhënat e stafit për program studimi vijojnë si më poshtë:

Kualifikimi i stafit akademik të programit të studimit	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	-	1	-	1	-	1
Prof.As.Dr	1	-	1	-	-	-
Dr	4	-	4	-	7	1
MSc	6	11	2	6	6	3
Total	11	12	7	7	13	5

Evidenca:

Evidenca 2.6 Plani mësimor i programit të studimit

Evidenca 2.7 Programet lëndore të programit të studimit

Tabelat permblledhese për Aneks_RVB MPInfermieristike

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Gjatë vizitës në institucion dhe gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion në sistem, GVJ konstatoi se FSHNH disponon një bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të përfshirë në programin e studimit “Master Profesional në Infermieristikë”. Ngarkesa mësimore e këtij program-studimi mbulohet në masën në masën 66% nga personeli akademik me kohë të plotë i dhe 34 % nga personeli akademik me kohë të pjesshme.

Evidenca:

Evidenca 2.4 Rregullorja e programit të studimit Master profesional në Infermieristikë

Evidenca 2.8 Curriculum Vitae të personelit akademik

Takim me Drejtuesin e Njësisë Kryesore dhe Njësisë Bazë

Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë

Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe nga takimet e zhvilluara gjatë

qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	vizitës në institucion, GVJ konstatoi qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar pranë programit të studimit. Personeli akademik efektiv i angazhuar në programin e studimit gjatë 2023-2025 nuk ka patur ndryshime të mëdha. Kjo vërehet në listën e PAE të tre viteve të fundit, por edhe në kontratat e punës të lidhura midis personelit akademik dhe institucionit, të cilat kanë të parashikuara mbulimin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga institucioni sipas ligjeve në fuqi. Evidenca: <i>RVB- MP në Infermieristikë</i> <i>Shtojca 1.2 Rregullorja e UNIKO</i> <i>Shtojca 1.13 Udhëzimi për rekrutimin e stafit akademik.</i> <i>Shtojca 1.14 Udhëzimi për përmbajtjen e dosjes së stafit</i> <i>Evidenca 2.8 CV Jetëshkrimet e stafit akademik të përfshirë në programin e studimit.</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Institucioni ndjek procedurë rekrutimi të mirëpërcaktuar në rregulloren e Burimeve Njerëzore si edhe në udhëzimin për rekrutimin e stafit akademik, ku përcaktohet qartë procedura e punësimit, që nga kërkesa për personel akademik efektiv, nga njësia bazë drejt njësisë kryesore, e më pas drejt Rektorit. Në kërkesat për punësim, përcaktohen edhe kriteret e përgjithshme dhe specifike në lidhje me kualifikimin profesional dhe akademik. <u>GVJ rekomandon unifikimin e CV sipas të njëjtit format</u> Evidenca: <i>RVB- MP në Infermieristikë;</i> <i>Evidenca 2.8 CV Jetëshkrimet e stafit akademik të përfshirë në programin e studimit.</i> <i>Shtojca 1.1 Statuti i universitetit 'Fan s. Noli'</i> <i>Shtojca 1.13 Udhëzim për rekrutimin e stafit akademik</i> <i>Shtojca 1.2 Rregullorja e Uniko.</i> <i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë, takim me përfaqësues të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivës</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik	<i>Nuk ka personel ndihmës akademik në këtë program studimi.</i>

të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Zyra Juridike dhe e Burimeve Njerëzore mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Në tabelat përmbledhëse, si dhe në dosjet e vëzhguara fizikisht në institucion, të dhënat përfshijnë anëtarët e personelit akademik të angazhuar në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrative. Të dhënat ruhen në formë të printuar si edhe elektronikisht. <i>GVJ evidenton që nuk janë në format digjitale, bioshort në website nuk janë.</i> Evidencat: <i>Evidenca: 2.2 Regullorja e FSHNH</i> <i>Evidenca 2.3 Regullorja e Departamentit të Infermierisë</i> <i>Evidenca 2.14 Formati i dosjes personale të stafit</i> <i>Shtojca 1.14 Udhëzim për përmbytjen e dosjes së stafit</i> <i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë, takim me përfaqësues të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivës</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së	GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi, dhe ju vunë në dispozicion, marrëveshje të bashkëpunimit me institucione të tjera, sipas referencave përkatëse me: Shërbimi Spitalor Rajonal, Korçë, Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Korçë, Qendra e Kujdesit Paliativ Mary Potter Korçë, Kryqi i Kuq Korçë, Qendra komunitare e shëndetit mendor Korçë, Shtëpia e foshnjës, Institucionet arsimore dhe rezidenciale të personave me aftësi të kufizuara. Në kuadër të këtyre marrëveshjeve në të gjitha këto institucione janë angazhuar infermierë që organizojnë dhe mbikëqyrin dhe monitorojnë studentët gjatë praktikave klinike. Praktika mbikëqyret nga personel akademik në vendin e aktivitetit dhe nga një anëtar nga

programit të studimit.	Departamenti i Infermierisë. GVJ evidenton që nuk ka një evidencë mbi numrin e studentëve për cdo grup praktike dhe cilat praktika udhëheqin cdo specialist në kurset përkatëse sipas <u>VENDIM. Nr. 41, datë 24.1.2018. PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA. INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË.</u> <i>Vihet re që në evidenca nuk ka grafik të dedikuar të orarit mësimor të programit.</i> GVJ nga vizita në institucion evidentoi se këto laboratore kanë nevojë për investime në pajisje. Evidencat: <i>Shtojca 2.9 Lista me marrëveshjet e bashkëpunimit për praktikat</i> <i>Grafiku i praktikave për MP Infermieristikë</i> <i>Takim me stafin</i>			
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Referuar RVB-së, praktikat klinike të programit MP në Infermieristikë realizohen në Spitalin rajonal Korçë sipas një grafiku të bërë nga Departamenti në bashkëpunim me Spitalin. Praktikrat institucionale konsistojnë në 75 orë praktikë. Një staf pedagogësh nga Departamenti i Infermierisë monitoron të gjitha aspektet akademike të praktikës, nga mbajtja e kontakteve të shpeshta personale me studentët deri te vlerësimi i raportit përfundimtar të paraqitur nga studentët, por nuk kemi një evidencë të këtij monitorimi të praktikës profesionale. Evidenca: <i>Evidenca 2.4 Rregullorja e programit të studimit Master Profesional në Infermieristikë</i> <i>Evidenca 2.6 Plani mësimor i programit të studimit</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se ky standart plotësohet pasi personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit. GVJ rekomandon marrjen e masave që stafi të avancojë në marrjen e titujve akademikë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	GVJ gjatë guidës në institucion vuri re se ky Institucion ka hapësirat e nevojshme për zhvillimin të programit mësimor “MP në Infermieristikë” si edhe për numrin e studentëve në këtë program. Por pajisjet nuk paraqiten mjaftueshem për një sigurim normal të praktikave laboratorike. <i>Evidenca:</i> <i>Vizita në institucion;</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	GVJ vërejti që mjediset e laboratorëve nuk janë të kompletuara me pajisje laboratorike, në të cilat studentët praktikisht realizojnë procedurat praktike në mënyrë të mjaftueshme. <i>Evidenca:</i> <i>Vizita në institucion;</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Nga vizita në institucion si edhe nga RVB evidentohet që në dispoziicion të studentëve në FSHNH 14 laboratorë, 9 prej të cilëve në Godinën B ku ndodhet Departamenti i Infermierisë. Laboratori i anatomisë, laboratori i obstetrikë-gjinekologjisë si edhe labore të tjera të, duhet të kenë një efijencë dhe funksionalitet më të lartë në realizimin e qëllimit kryesor për studentët e MP në Infermieristikë. GVJ vërejti që mjediset e laboratorëve nuk janë të kompletuara me pajisje laboratorike, në të cilat studentët praktikisht realizojnë procedurat praktike në mënyrë të mjaftueshme. <i>Evidenca:</i> <i>Evidenca 1.15 Raport i jkontrollit të MASR për kapacitete pritëse te UNIKO 2023-2024</i>

	<i>Evidenca 3.25 Analiza vjetore te FSHN</i> <i>Vizita në institucion</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Nga vizita në institucion GVJ evidentoi se departamenti i informatikës u krijon mundësinë studentëve të programit “MP në Infermieristikë”, që t’i përdorin këto mjedise, 2 laboratorë në teknologji informacioni, të pajisura me kompjutera dhe me internet. Në këto kompjutera studentët e programit MP zhvillojnë lëndet të teknologjisë së informacionit dhe ku mund të punojnë tezën e diplomës. GVJ vëren se nuk ka programe profesionale për zhvillimin e praktikave në kuadër të simulacioneve apo rasteve studimore/klinike. <i>Evidenca:</i> <i>Vizita në institucion</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.	Nga RVB, takimet e zhvilluara në institucion GVJ evidentoi se praktikat klinike dhe mësimore të cilat ofrohen në kuadër të programit Master Profesional në Infermieristikë zhvillohen në institucionet me të cilat Universiteti ka lidhur marrëveshje institucionale. <i>GVJ evidentoi se praktikat e studentëve të këtij cikli studimi zhvillohen në institucionet shëndetësore me të cilat ky institucion ka marrëveshje, sipas edhe kurrikulës që ata kanë.</i> <i>Evidenca:</i> <i>Evidenca 2.9 Lista me marrëveshjet të bashkëpunimit për praktikat</i> <i>Evidenca 2.13 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione në rang UNIKO</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Konkluzione	<i>GVJ mendon se FSHNH disponon mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatura me fushën e programit të studimit, por për formimin praktik nuk mund të themi të njëjtën gjë pasi ambientet e laboratorëve nuk janë të pajisur me pajisje laboratorike që të mundësojnë praktikimin e procedurave infermierore që ata</i>

	<i>marrin në teori. Po ashtu nuk kemi programe profesionale për të zhvilluar praktika simulatore apo raste studimore/klinike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	GVJ bazuar në dokumentat e vëna në dispozicion, vizitën në institucion, takimin me stafin dhe studentët u informua se, studentët dhe stafi kanë në dispozicion një gamë të gjerë tekstesh fizike dhe on-line (biblioteka online J-store dhe U-library. Studentët dhe pedagogët citohet që komunikojnë edhe nëpërmjet platformave elektronike për materiale dhe informacion, por nuk paraqesin një evidence të tilla si psh google classroom, moodle, apo sisteme të ngjashme. Evidenca: <i>Evidenca 2.8 CV Jetëshkrimet e stafit akademik të përfshirë në programin e studimit.</i> <i>Evidenca 4.10 Të dhëna për fondin e librave në bibliotekë</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njësive Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik; takim me studentët</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	GVJ u informua se stafi akademik çdo fund-viti akademik përditëson syllabusin, temat përkatëse, literaturën bazë dhe atë të rekomanduar, ciklin e leksioneve dhe bazuar në këtë përditësim bën dhe kërkesën për literaturë fizike apo on-line. GVJ rekomandon përditësim të literaturës me botime të viteve të fundit. GVJ evidenton që ka nevojë për përmirësim në dokumentacion në lidhje me tekstet e miratuara në departament, bazuar edhe në praktikën të shkruar për miratimin e planeve mësimore, psh duke kaluar nga titullari lëndës, kordinatori programit apo dhe drejtuesi i grupit mësimor/shkencor.

	Evidenca: <i>Evidenca 2.7; programet lëndore të programit të studimit (syllabuset).</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Nga vizita në institucion GVJ konstatoi që biblioteka pranë FSHN ishte e mbyllur për shkak të punimeve për mirëmbajtjen e godinës.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.	GVJ gjatë vizitës në institucion dhe takimin me stafin u informua se Fondi i librave të bibliotekës të FSHNH përmban një numër të konsiderueshëm vëllimesh revista shkencore, koleksione si tekste mësimore, bazë literaturë ndihmëse në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj. Studentët dhe stafi akademik kanë të drejtë pa pagesë shfrytëzimin jo vetëm të literaturës fizike, por edhe on-line, për realizimin sa më të mirë të procesit mësimor dhe moduleve të programit “MP në Infermieristikë”. Por nuk përdorej, në kohën e vizitës që GVJ zhvilloi, për shkak të procesit të rikonstruksionit në të cilin është përfshirë. Evidenca: <i>Evidenca 4.10 Të dhëna për fondin e librave në bibliotekë</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik; takim me studentët</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	GVJ konstatoi nga bisedimet me drejtuesit e njësisë bazë dhe asaj kryesore, si edhe nga RVB, që FSHNH është abonuar në bibliotekën on line J-store dhe U-library, të cilat shfrytëzohen nga stafi dhe studentët. Gjithshtu nëpërmjet projektit CleanScore, i vënë në dispozicion nga institucioni në bashkëpunim me MAST dhe AADF, studentet mund të aksesojnë edhe librarinë EBSCO ku mund të shkarkojnë libra mësimorë, artikuj dhe revista shkencore. Por nuk gjetëm evidencat e duhura për këto të dhëna.
	Evidenca: <i>Evidenca 4.10 Të dhëna për fondin e librave në bibliotekë</i>

	<i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë; Takim me stafin akademik; takim me studentët</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	GVJ konstatoi se biblioteka e FSHNH është përkohësisht jashtë shërbimit për shkak të rikonstruksionit.
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka e FSHNH, sipas atyre çfarë na referuan drejtuesit e njësisë bazë dhe kryesore, ka një rregullore të funksionimit. Aktualisht godina e bibliotekës është në proces rinovimi dhe mirëmbajtje. Proçesi i rikonstruksionit në të cilin është përfshirë biblioteka synon edhe përmirësim të fondit të librave dhe numrit të vendeve për studentët. Evidenca: <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë; Takim me stafin akademik; takim me studentët</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitet përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Biblioteka funksiononte në bazë të një rregulloreje ku çdo gjë dokumentohej në bazë të kartelave për studentë dhe për staf. Orientimi i studentëve për përzgjedhjen e literaturës në përgjithësi bëhej nga stafi akademik. Por gjithçka mbetet në kuadër të konfirmimeve dhe nuk kemi evidenca konkrete të situatës.
Konkluzione	<i>FSHNH ka një Bibliotekë Universitare, që sipas stafit ka hapësira të dedikuara dhe të bollshme për studentët, por për shkak të</i>

	<i>rikonstruksionit GVJ nuk pati mundësi t'i shikonte nga afër. Biblioteka është në funksion të programit mësimor si për studentët dhe pedagogët.</i> <i>GVJ vërejti që mjediset e laboratorëve nuk janë të kompletuara me pajisje laboratorike, në të cilat studentët praktikisht realizojnë procedurat praktike në mënyrë të mjaftueshme.</i> <i>GVJ vëren se nuk ka programe profesionale për zhvillimin e praktikave në kuadër të simulacioneve apo rasteve studimore/klinike.</i> <i>Studentët dhe pedagogët citohet që komunikojnë edhe nëpërmjet platformave elektronike për materiale dhe informacion, por nuk paraqesin një evidence të tillë si psh google classroom, moodle, apo sisteme të ngjashme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	FSHNH ka sistem menaxhimi të brendshëm për administrimin e informacionit që lidhet studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. PITAGORA është aplikacioni i sekretarisë online i zhvilluar nga RASH, i cili ofron funksionalitete për sekretarinë, studentët dhe pedagogët për menaxhimin e të gjithë ciklit akademik të studimeve, si dhe regjistri themeltar sipas formatit të miratuar nga MAS. GVJ konstatoi se nuk ka platforma te institucionit me funksione të shumëfishta në administrimin e aktivitetit akademik, mësimor dhe trajnues. Evidenca: <i>Evidenca: 1.6; Manual i sistemit elektronik pitagora;</i> <i>Evidenca: 1.6.1; Marrëveshja me RASH për sistemin elektronik Pitagora;</i> <i>Takim me stafin, studentët dhe sekretarinë mësimore</i>

	<i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Zyra e Burimeve Njerëzore në FSHNH, administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. FSHNH nëpërmjet sistemit PITAGORA, mundëson, përveç shërbimeve të sekretarisë, edhe menaxhimin e detyrimeve akademike të studentëve. Nëpërmjet sistemit të brendshëm Pitagora administrohet informacioni dhe dokumentacioni në lidhje me hedhjen e notave dhe gjenerimin e procesverbalit. Pjesa tjetër nuk konfigurohet. Evidenca: <i>Evidenca:</i> 1.6; Manual i sistemit elektronik pitagora; <i>Evidenca:</i> 1.6.1; Marrëveshja me RASH për sistemin elektronik Pitagora; <i>Takim me stafin, studentët dhe sekretarinë mësimore</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Zyra e Burimeve Njerëzore në FSHNH, administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. FSHNH nëpërmjet sistemit PITAGORA, mundëson, përveç shërbimeve të sekretarisë, edhe menaxhimin e detyrimeve akademike të studentëve. Nëpërmjet sistemit të brendshëm Pitagora administrohet informacioni dhe dokumentacioni në lidhje me hedhjen e notave dhe gjenerimin e procesverbalit. Pjesa tjetër nuk konfigurohet.
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Nga vizita në institucion GJV evidentoi se institucioni nëpërmjet sistemit të menaxhimit Pitagora, mundëson komunikimin, informimin e studentëve në lidhje me veprimtari, takime, mbledhje, diskutime, kërkim shkencor, mobilitete, etj. Sistemi i menaxhimit nuk ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.

	UNIKO nuk përdor platforma për edukimin në distancë jo vetëm për procesin akademik por edhe për informimin e studentëve dhe zhvillimin e veprimtarive të tjera si takime, mbledhje, ëëbinar, prezantime, diskutime etj. Nuk ka sistem, nëpërmjet një portali të posaçëm, ku studentët informohen jo vetëm me njoftimet për procesin mësimor por edhe për veprimtari të tjera apo informacione të nevojshme që lidhen me kërkimin shkencor, aktivitetet studentore, mobilitetet etj. Nuk ka sistem, ku të dhënat në lidhje me veprimtaritë, leksionet, detyrat dhe materiale të tjera, personeli akademik dhe studentët mund të kryejnë nëpërmjet një platforme digjitale. Evidenca: <i>Evidenca: 1.6; Manual i sistemit elektronik pitagora;</i> <i>Evidenca: 1.6.1; Marrëveshja me RASH për sistemin elektronik Pitagora;</i> <i>Evidenca 1.10 rregullore e sektorit të studimeve dhe sektorit TIK</i> <i>Takim me stafin, studentët dhe sekretarinë mësimor</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	UMIKO, FSHNH, me anë të sistemit të dixhitalizimit siguron akses, përdorim, informacion në kohë reale të materialeve në modulet e programit që studenti frekuentonte. Falë Zyrës së IT bëhej e mundur mirëmbajtja e sistemit duke bërë të mundur përdorimin në çdo kohë. Gjithashtu, sekretaria, përgjegjësit e programeve, stafi akademik dhe studentët mund të marrin të dhëna në çdo kohë. Por ky sistem i menaxhimit nuk garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ, si edhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale, për organet drejtuese dhe autoritetet drejtuese të UK. Evidenca: <i>Evidenca: 1.6; Manual i sistemit elektronik pitagora;</i> <i>Evidenca: 1.6.1; Marrëveshja me RASH për sistemin elektronik Pitagora;</i> <i>Evidenca 1.10 rregullore e sektorit të studimeve dhe sektorit TIK</i> <i>Takim me stafin, studentët dhe sekretarinë mësimor</i>

	<i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	UNIKO zotëron një faqe web aktive, që mund të aksesohet nga çdo njeri. Kjo faqe është dinamike dhe përveç informacioneve të ndryshme, publikon në mënyrë periodike aktivitetin e fakultetit, të departamenteve dhe njësive të tjera. <i>GVJ sygjeron që publikimet në këtë faqe të bëhen edhe në gjuhën angleze.</i> Evidenca: <i>Evidenca: 4.8; Webfaqja e UK https://unkorce.edu.al/</i> <i>Evidenca: 4.9; Webfaqja e FSHNH https://unkorce.edu.al/fakulteti-i-shkencave-natyrore-dhe-shkencave-humane-3/</i> <i>Takim me stafin, studentët dhe sekretarinë mësimor</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë</i>			
Konkluzione	<i>Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për studentët dhe pedagogët. Çdo student ka llogarinë e tij në këtë sistem ku në mënyrë konfidencialë merr informacion për rezultatet e provimeve gjatë vitit akademik. Por GVJ konstatoi se nuk ka platforma të institucionit me funksione të shumëfishta në administrimin e aktivitetit akademik, mësimor dhe trajnues.</i> <i>Sistemi i menaxhimit nuk ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë formë të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. Në sajë të dixhitalizimit, sistemi i menaxhimit nuk garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrative.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton	Bazuar në materialin e RVB-së, evidencat përkatëse, si edhe

një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.

informacionet e marra gjatë vizitës 2-ditore në institucion, u evidentua që FSHNH harton raportin vjetor, një raport mjaft i rëndësishëm për të gjithë informacionin që ofron. Në këtë raport përfshiheshin të dhënat vjetore për aktivitetin mësimor, kërkimor shkencor dhe atë financiar. Raporti vjetor përmbledh analizën vjetore të Departamentit të Infermierisë, çdo njësi tjetër bazë, njësi kryesore e administrative në FSHNH dhe UK. Nga shqyrtimi i evidencave GVJ nuk konstaton praninë e raportit financiar të kostove të njësisë bazë për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e këtij programi për një cikël të plotë studimi.

Evidenca:

Evidenca 1.7; Rregullore e Drejtorisë Ekonomike;

Evidenca 1.8; Rregullore e Drejtorisë së Financës (EDE);

Evidenca 1.8.1 Rregullore Financiare e Shpërndarjes së të Ardhurave të UK;

Evidenca 1.11; Rregullore e Senatit Akademik;

Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Në FSHNH, përgatitja e buxhetit, mënyra e shpërndarjes së fondeve dhe përdorimit të tyre, është kompetencë e institucionit dhe menaxhohet nga Bordi i Administrimit. Propozimet vijnë nga baza dhe miratimi i tyre bëhet nga Rektorati. Proçesi i hartimit të buxhetit nis me diskutimet dhe marrjen e propozimeve nga njësitë bazë dhe strukturat administrative. Pas shqyrtimit dhe miratimit të propozimeve, fakulteti përcjell planin në nivel fakulteti në Rektorat. Në planin e financimit përfshiheshin zëra për burimet njerëzore dhe infrastrukture, materialet e konsumit dhe materialet për laboratore, pajisjet, zhvillimin e praktikave spitalore, pasurimin e bibliotekës, mundësitë e mbështetjes financiare në fushën e kërkimit shkencor për stafin akademik. Por ajo që u evidentua është që njësia bazë nuk përfshihet në këtë proces. Evidenca: <i>Evidenca 1.7;</i> Rregullore e Drejtorisë Ekonomike; <i>Evidenca 1.8;</i> Rregullore e Drejtorisë së Financës (EDE); <i>Evidenca 1.8.1</i> Rregullore Financiare e Shpërndarjes së të Ardhurave të UK; <i>Evidenca 3.15;</i> Praktika e miratimit të Buxhetit UK
---	--

Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Bazuar në dokumentacionet e sjella, NJAB (Njësia e Auditimit të Brendshëm) është struktura e ngritur në nivel universiteti për të kryer auditimin periodik. NJAB ushtron veprimtari të pavarur, dhe në mënyrë sistematike ndihmon në vlerësimin dhe përmirësimin e proceseve të menaxhimit të brendshëm të institucionit. Kështu FSHNH në përbërje të së cilës është edhe <i>Departamenti i Infermierisë, si pjesë përbërëse e UK, kryejnë veprimtarinë e tyre financiare në përputhje me planet e miratuara nga Rektorati.</i> Gjatë takimit me drejtuesen e departamentit dhe me drejtuesin e njësisë kryesore na u shpjeguan qartësisht etapat që ndiqeshin deri në hartimin final të Raportit Vjetor, ashtu sikurse ishte paraqitur edhe në dokumentacionet e dorëzuara. Evidencat: <i>Evidenca 2.4.; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2021-2022, 2022-2023, 2023-2024</i> <i>Evidenca 2.13; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2021-2022, 2022-2023, 2023-2024</i> <i>Evidenca 1.8.1 Rregullore Financiare e Shpërndarjes së të Ardhurave të UK;</i> <i>Evidenca 1.15; Raport i kontrollit të MASR për kapacitetet pritëse të UK 2023-2024</i> <i>Takim me drejtuesit e njësisë bazë.</i>
---	---

Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Bazuar në dokumentacionet e sjella, NJAB (Njësia e Auditimit të Brendshëm) është struktura e ngritur në nivel universiteti për të kryer auditimin periodik. NJAB ushtron veprimtari të pavarur, dhe në mënyrë sistematike ndihmon në vlerësimin dhe përmirësimin e proceseve të menaxhimit të brendshëm të institucionit. Kështu FSHNH në përbërje të së cilës është edhe <i>Departamenti i Infermierisë, si pjesë përbërëse e UK, kryejnë veprimtarinë e tyre financiare në përputhje me planet e miratuara nga Rektorati.</i> Gjatë takimit me drejtuesen e departamentit dhe me drejtuesin e njësisë kryesore na u shpjeguan qartësisht etapat që ndiqeshin deri në hartimin final të Raportit Vjetor, ashtu sikurse ishte paraqitur edhe në dokumentacionet e dorëzuara. <i>Evidenca 2.4.; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2021-2022, 2022-2023, 2023-2024</i> <i>Evidenca 2.13; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2021-2022, 2022-2023, 2023-2024</i> <i>Evidenca 1.8.1 Rregullore Financiare e Shpërndarjes së të Ardhurave të UK;</i> <i>Evidenca 1.15; Raport i kontrollit të MASR për kapacitetet pritëse të UK 2023-2024</i> <i>Takim me drejtuesit e njësisë bazë.</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të	GVJ bazuar në RVB, referencat përkatëse si dhe takimin me drejtuesit e institucionit konstaton se institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Të ardhurat siguroheshin kryesisht nga tarifat e shkollimit dhe të ardhurat nga shërbimet që kryhen, siç janë edhe shërbimet ndaj të tretëve, por në fakt nuk gjejmë evidencë për këtë fakt. Evidenca: <i>Evidenca 2.4.; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë</i>

programeve të studimeve.	mësimore, kërkimore dhe financiare i UK <i>Evidenca 1.8.1 Rregullore Financiare e Shpërndarjes së të Ardhurave të UK;</i> <i>Evidenca 3.7; Raporti Institucional i vlerësimit të brendshëm UK (relacion)</i> <i>Evidenca 3.15; Praktika e miratimit të Buxhetit UK</i> <i>Evidenca 5; Tabela Përmbledhëse për aneks RVB</i> <i>Takim me drejtuesit e njësisë bazë dhe njësisë kryesore</i>			
	<i>Çdo vit akademik UK dhe FSHNH hartojnë raportin financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarrëvajtjen e programit të studimit Master Profesional në Infermieristikë dhe mbështetjen e studentëve. UK garanton qëndrueshmërinë financiare për realizimin e objektivave dhe misionit të tij, bazuar në të ardhurat që siguron nga tarifat e shkollimit dhe të ardhurat nga shërbimet që kryhen. Por nuk është e vendosur në nivel departamenti.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe	GVJ gjatë bashkëbisedimit me drejtues të institucionit, studentët, sekretarinë mësimore, RVB, konstatoi se ky institucion harton

procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	politika dhe procedura të sakta gjatë vitit akademik të studentëve (në hyrje dhe në përfundim të studimeve), në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi. Institucioni disponon akte rregullatore për strukturat dhe njësitë kryesore në përputhje me statutin e universitetit. Institucioni, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të miratuara nga Senati Akademik, zbaton procedura, të cilat garantojnë të drejta të njëjta, për të gjithë studentët. Mundësohet ndjekja korrekte e kandidatit që nga momenti i aplikimit deri në përmbylljen e detyrimeve akademike dhe diplomimin e tij. Evidenca: <i>Evidenca 1.1</i> Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë <i>Evidenca 1.2;</i> Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë <i>Evidenca 2.2;</i> Rregullore e Njwsisw Kryesore Takim me studentët Takim me drejtuesit e Njesisë Bazë, Njesisë Kryesore
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Gjatë vizitës në institucion, në sekretarinë mësimore, GVJ vuri re se ky institucion bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Shqiptar, statutin e UK siguron barazinë bazuar mbi kriteret dhe procedurat për të gjithë kandidatët për t'u regjistruar në Programin e Studimit të Diplomës Master Profesional në Infermieristikë. Studentët kanë mundësi të njëjta informimi, studimi, kandidimi për forume drejtuese, pjesëmarrje në aktivitete promovuese, konkurimi për bursa apo mobilitete në kuadër të projekteve të ndryshme. Përzgjedhja realizohet me procedura transparente. Evidenca: <i>Evidenca 1.1;</i> Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë <i>Evidenca 1.2;</i> Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë <i>Evidenca 2.2;</i> Rregullore e Njwsisw Kryesore https://unkorce.edu.al/kriteret-e-pranimit/
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e	GVJ në takimin me stafin akademik dhe studentët si dhe dokumentat e vëna në dispozicion, u informua dhe konstatoi se para çdo viti akademik, bazuar në afatet e përcaktuara nga MASR, departamenti përcakton kriteret specifike dhe kuotat e

kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	pranimi, të cilat miratohen në dekanat dhe aprovohen nga Senati Akademik. UK harton dhe publikon përpara çdo viti kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, duke u bazuar në vendimet e Senatit Akademik në mbështetje të kriterëve kombëtare, të propozuara nga njësitë bazë. Në material specifikohet që "Në këto kriteret përfshihen dhe parashikohen edhe regjistrimi i studentëve të huaj", por në fakt nga ajo që pamë në RVB dhe evidencat përkatëse nuk kishte lëndë apo, module në gjuhë të huaj. <i>GVJ sugjeron që të krijohet mundësia si fillim për të dhënë lëndë apo module në gjuhë të huaj.</i> Evidenca: <i>Evidenca 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë</i> <i>Evidenca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë</i> <i>Evidenca 2.2; Rregullore e Njesisë Kryesore</i> <i>Evidenca 2.3; Rregullore e njesisë bazë "Departamenti i Infermierisë";</i> <i>Takim me studentët</i> <i>Takim me drejtuesit e Njesisë Bazë, Njesisë Kryesore</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimi përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	GVJ konstatoi se UK ka rregullore të veçantë për transferimin e studentëve nga programe të ngjashme dhe ndjekjen e programeve të dyta studimi. Kështu që studentët kanë mundësi të informohen në lidhje me transferimin apo ndjekjen e fakulteteve të dyta. Evidenca: <i>Evidenca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë</i> <i>Evidenca 2.2- Rregullore e FSHNH</i> <i>Evidenca 2.4- Rregullorja e Programit të Studimit</i> https://unkorce.edu.al/kriteret-e-pranimi/ <i>Takim me studentët</i> <i>Takim me drejtuesit e Njesisë Bazë, Njesisë Kryesore</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e	GVJ konstatoi se UK informon publikun dhe të gjithë të interesuarit nëpërmjet informacioneve me anë fletëpalosjeve, faqes zyrtare web, rrjeteve sociale, etj. Këto informacione u jepen studentëve edhe gjatë ndjekjes së studimeve bachelor, që ata zhvillojnë në FSHNH, lidhur me kriteret e përgjithshme dhe

përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	specifike për pranimin në programin MP në Infermieristikë, mundësinë e punësimit pas përfundimit të programit të studimit, etj. Një informacion i plotë për ta ofrohet edhe në faqen web të UNIKO. Evidenca: Webfaqja e UK https://unkorce.edu.al/ Webfaqja e FSHNH https://unkorce.edu.al/fakulteti-i-shkencave-natyrore-dhe-shkencave-humane
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Politikat që ndjek UK, bazuar në atë çfarë evidentuam në RVB, nuk përbëjnë diskriminim për studentët me përkatësi të ndryshme, dhe në këtë mënyrë sigurohet barazia për të gjithë kandidatët me aftësi të veçanta. <i>Por GVJ konstatoi se FSHNT me infrastrukturën që ka, nuk është e përshtatshme për t'u aksesuar nga ana e studentëve me aftësi të kufizuar.</i> Evidenca: Evidenca 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë Evidenca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	UK i ofron mundësi studentëve që vijnë nga trojet apo shtetas të huaj për të ndjekur studimet. Nëpërmjet faqes Web të UK, fletë palosjeve, reklamave televizive, ofron informacion për mënyrën e ndjekjes së procedurave për regjistrim. Megjithatë nuk u konstatua pjesëmarrja e këtij kontigjenti në këtë universitet, dhe në këtë program studimi. <u>Nuk kemi një evidencë të një procedure të tillë.</u> Evidenca: Evidenca 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë Evidenca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	GVJ konstatoi se UK në politikat e saj ofron mbështetje financiare për studentët me rezultate të larta, si edhe ka politika mbështetëse për shtetas në nevojë duke i mbështetur ata nga ana ekonomike. Nuk kemi ndonjë evidencë të një rasti konkret në programin e studimit “MP në Infermieristikë”. Evidenca: Evidenca 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë

	<i>Evidenca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë</i>			
Konkluzione	<i>UK dhe FSHNH, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit MP në Infermieristikë, bazuar në aktet ligjore.</i> <i>UK, ndjek politikë mbështetëse për studentët e shtresave në nevojë duke i ndihmuar ekonomikisht si edhe për dhe studentët me nevoja dhe statuse të veçanta, ofron lehtësira financiare.</i> <i>GVJ sugjeron që të krijohet mundësia si fillim për të dhënë lëndë apo module në gjuhë të huaj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	GVJ, referuar dokumentacionit të dorëzuar, rregullores së programit të studimit, faqes zyrtare të web si dhe takimit me përfaqësues të tij, konkludon se i gjithë informacioni i plotë dhe i hollësishëm gjendet në rregulloren mësimore të programit të studimit dhe aktet e tjera rregullatore. Gjithashtu u konstatua se studentët informoheshin nga zyra e informimit dhe orientimit të studentëve në FSHNH, përgjegjësi i programit të studimit në lidhje me rregulloret e shkollës, rregulloren e programit, kushtet e frekuentimit, format e kontrollit, pikëzimet, etj. <u>GVJ sugjeron që</u> Zyra e Këshillimit të Karrierës duhet të jetë shumë më pranë studentëve duke punuar akoma edhe më shumë në këtë drejtim për informimin e studentëve në mënyrë që ata ta kenë fokusin te kjo zyrë për cfarëdolloj informacioni. Evidenca: <i>Evidenca 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë</i> <i>Evidenca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë</i> <i>Evidenca 2.2 rregullorja e FSHNH</i> <i>Evidenca 2.3 Rregullore e Departamentit të Infermierisë</i>

	<i>Evidenca 2.4; Rregullorja e programit të studimit MP në Infermieristikë</i> <i>Takim me të githa nivelet e përfaqësuesve të institucionit</i> <i>Takim me studentët dhe pedagogët</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	GVJ konstatoi se UK disponon rregullore në lidhje me transferimet dhe programet e dyta të studimit ku studentët marrin informacion në lidhje me procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Në pikën 17 të Rregullores së Programit të studimit MP në Infermieristikë, përcaktohet mundësia e transferimit të studimeve, ndërkohë që nuk kemi një specifikim të procedurës së transferimit, ndërsa neni 33 i Rregullores së FSHNH, përcakton kushtet e ndjekjes së një programi të dytë studimi. Evidenca: <i>Evidenca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë</i> <i>Evidenca 2.2 Rregullorja e FSHNH</i> <i>Evidenca 2.3 Rregullore e Departamentit të Infermierisë</i> <i>Evidenca 2.4; Rregullorja e programit të studimit MP në Infermieristikë</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	GVJ konstatoi nga RVB dhe nga takimi që pati me studentet se studentët informohen mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit MP në Infermieristikë nëpërmjet rregullores së fakultetit, departamentit dhe programit të studimit, syllabuseve të lëndëve të publikuara dhe prezantimit të pedagogut përkatës, si edhe nëpërmjet sistemit Pitagora. Informimi i studentëve lidhur me vlerësimin e dijeve bëhet nëpërmjet sistemit Pitagora ku çdo student merr informacion në llogarinë e vet në momentin që pedagogu vendos vlerësimin. Evidenca: <i>Evidenca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë</i> <i>Evidenca 1.6; Manual i sistemit elektronik pitagora</i> <i>Evidenca 2.2 Rregullorja e FSHNH</i> <i>Evidenca 2.3 Rregullore e Departamentit të Infermierisë</i> <i>Evidenca 3.21– Korrigjimi i automatizuar i provimeve Raport mbi korrigjimin e automatizuar te provimeve</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në	GVJ konstatoi se diplomimi i studentëve të Ciklit të Dytë të studimeve në “Master Profesional në Infermieristikë” bëhet me

lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	mbrojtjen e mikrotezës. Departamenti përcakton listën e temave të diplomave, brenda muajit dhjetor të semestrit të parë të vitit akademik, i cili bazohet në fushat e studimit që mbulon departamenti. Evidenca: <i>Evidenca 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë</i> <i>Evidenca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë</i> <i>Evidenca 2.2 rregullorja e FSHNH</i> <i>Evidenca 2.3 Rregullore e Departamentit të Infermierisë</i> <i>Evidenca 2.4; Rregullorja e programit të studimit MP në Infermieristikë</i> <i>Evidenca 2.12 – Manual për punimin e diplomës</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	GVJ konstatoi se UK përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, informojnë të gjithë të interesuarit, në lidhje me programin e studimit MP në Infermieristikë, në forma të ndryshme, si fletëpalosje informuese, postera, publikime në faqen web të UK, në rrjetet sociale, etj. Në ditët e informimit të maturantëve organizohen takime të hapura informuese në shkollat e mesme të Qarkut të Korçës. Megjithatë nga ajo që vetë stafi konfirmon, është fakti që në përgjithësi studentët e ciklit Master Profesional në “Infermieristikë” e përgjithshme janë studentët që më së shumti zgjedhin këtë master. Evidenca: <i>Evidenca 3.9 – Praktika e promovimit dhe informimit të maturantëve</i> <i>Evidenca 3.10 – Praktika e informimit të studentëve me programin e studimit</i> https://unkorce.edu.al/
Konkluzione	<i>Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurave të vlerësimit të dijeve, kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit MP në Infermieristikë. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, UK informon publikun për programet e studimit që ofron duke organizuar takime të hapura me të interesuarit dhe studentët e ardhshëm mbi programin e</i>

	<i>studimit, fletë palosjeve informuese, informacionit në faqen e webit të universitetit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	GVJ në bazë të dokumentave referuese, planet mësimore, rregullore, statutit, takimit me drejtues të institucionit, sekretarinë mësimore, studentët konstaton se, UK vendos në dispozicion të studentëve informacionin e nevojshëm rreth strukturës, organizimit të programit mësimor dhe kohëzgjatjes së programit të studimit. Informacionin studentët e marrin nëpërmjet takimeve me stafin akademik që i pret në institucion në momentin që interesohen për programet e studimit nëpërmjet kontakteve me Zyrën e Informacionit dhe Orientimit të studentëve, si edhe nëpërmjet sekretarisë mësimore të Departamentit të Infermierisë. Evidenca: <i>Evidenca 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë</i> <i>Evidenca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë</i> <i>Evidenca 2.2 rregullorja e FSHNH</i> <i>Evidenca 2.3 Rregullore e Departamentit të Infermierisë</i> <i>Evidenca 2.4; Rregullorja e programit të studimit MP në Infermieristikë</i> <i>Takimi me studentët; stafin akademik; sekretarinë mësimore;</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	GVJ bazuar në takimin me drejtues të institucionit, takimin me stafin akademik, sekretarinë mësimore si dhe takimin me studentët mendon se: UK informon studentët në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit “Master Profesional në Infermieristikë”.

	Evidenca: Evidenca 2.2 Programi i lëndëve në MP në Infermieristikë
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	UK vë në dispozicion Qendrën e Karrierës për studentët në lidhje me orientimin apo mundësitë e punësimit. Kjo zyrë së bashku me departamentin, janë përgjegjëse për cdo informim për të cilin ka nevojë studenti. GVJ evidentoi se nuk ka një evidencë konkrete lidhur me gjurmimin e studentëve pas diplomimit dhe punësimin e tyre. Evidenca: Evidenca 3.1.9– Analiza vjetore e Qendrës së Karrierës dhe ALUMNI
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ gjatë vlerësimit të dokumentacionit dhe takimit me studentët evidentoi që studentët informohen dhe gjerësisht për infrastrukturën dhe organizimin e programit të studimit, duke filluar nga organizimi i syllabuseve, orari i mësimit, logjistikën, laboratorët, modalitetet e organizimit të praktikave profesionale dhe strukturat ndihmëse. Praktika profesionale ofrohet sipas marrëveshjeve, në spital. Në funksion të studentëve është edhe biblioteka (e cila në momentet e vizitës ishte në rikonstruksion dhe nuk patëm mundësinë të shihnim nga afër) dhe shërbimet e sekretarisë. Evidenca: Evidenca 1.10– Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe Sektori të TIK Takim me studentët
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	GVJ konstatoi se UK informon studentët nëpërmjet platformës të brendshme elektronike PITAGORA që ndodhet në faqen zyrtare web të UK. Evidenca: Evidenca 1.6 Marrëveshja me RASH për sistemin elektronik Pitagora; Evidenca 1.6.1; Manual i sistemit elektronik pitagora
Konkluzione	UK dhe programi i studimit në “Master Profesional në Infermieristikë” i siguron infrastrukturën e nevojshme studentëve për marrjen e informacionit të hollësishëm lidhur me organizimin e programit të studimit, duke filluar nga organizimi i syllabuseve

	orari i mësimi, aktivitet jashtë kurrikulare (edhe pse nuk kemi një evidencë konkrete me aktivitete të tilla për këtë program studimi), logjistikën, laboratorët, modalitet e organizimit të praktikave profesionale, literaturën e nevojshme dhe strukturat ndihmëse. Institucioni mundëson përfshirjen e studenteve në aktivitete informuese.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi								
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.	Bazuar në informacionin në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UK mban dhe disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar sipas programeve dhe cikleve të studimit. Sekretaria mësimore mbante informacion në lidhje me studentët e regjistruar duke ju referuar udhëzimeve të MAS dhe QSHA, në formë fizike dhe elektronike. Evidenca: - Evidenca 3.25– Analiza vjetore e FSHNH								
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Gjatë vizitës në UK, GVJ konstatoi se regjistrat e sekretarisë mësimore (themeltar, i arritjeve akademike dhe ai i dhënies së diplomave) janë të formatuar dhe të përditësuar sipas standardeve ligjore në fuqi. Pranë sekretarisë depozitohen edhe dokumentacioni i përgatitur nga personeli akademik lidhur me frekuentimin e studentëve dhe procesverbalet e vlerësimeve sipas lëndëve. Të dhënat për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi për 3 vitet e fundit akademike paraqiten si vijon: <table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th><th>Të regjistruar</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2022-2023</td><td>29 studentë</td></tr> <tr> <td>2023-2024</td><td>38 studentë</td></tr> <tr> <td>2024-2025</td><td>40 studentë</td></tr> </tbody> </table>	Viti akademik	Të regjistruar	2022-2023	29 studentë	2023-2024	38 studentë	2024-2025	40 studentë
Viti akademik	Të regjistruar								
2022-2023	29 studentë								
2023-2024	38 studentë								
2024-2025	40 studentë								

	Evidenca: <i>Takim me sekretarinë mësimore.</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Bazuar në informacionin e RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se ruajtja dhe menaxhimi i të dhënave statistikore të studentëve realizohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kërkesat e statutit dhe rregulloreve të UK. Në sekretarinë mësimore ndodhej dokumentacioni i duhur për arritjet e studentëve në bazë të moduleve dhe cikleve akademike. I gjithë informacioni ruhej në formë fizike po ashtu dhe në formë elektronike të një sistemi të brendshëm të sigurt dhe të verifikueshëm nga persona të autorizuar. Evidenca: <i>Evidenca 1.6.1; Manual i sistemit elektronik pitagora;</i> <i>Evidenca 1.9; Rregullore për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale</i> <i>Shtojca 1.10– Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe Sektori t të TIK</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Njësia e Auditimit të Brendshëm është strukturë e posacme e cila mbikqyr, vlerëson dhe garanton autonominë e institucionit. Kjo njësi n.p.m. një plani vjetor pune të miratuar nga titullari i institucionit ushtron kontrole periodike pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit). Sekretaria Mësimore e FSHNH është strukturë ndihmëse akademike me karakter administrativ, në nivel institucioni e cila zhvillon veprimtarinë në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Nga vizita që patëm në zyrat e sekretarisë, GVJ konstatoi se regjistrat ishin të përpiluar në mënyrë korrekte pa ndërhyrje apo korrigjime. Evidenca: <i>Evidenca 1.6.1; Manual i sistemit elektronik pitagora;</i> <i>Evidenca 1.10; Rregullore e sektorit të studimeve dhe sektorit të TIK</i> <i>Evidenca 1.16; Manuali i cilësisë UK;</i>
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe	Referuar RVB-së, institucioni përpilon një raport vjetor gjithëpërfshirës të të gjitha njësive dhe programeve që ofrojnë, ku mes të tjerash analizohet cilësia e studentëve në hyrje dhe në

cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	dalje.			
Konkluzione	Evidenca: <i>Evidenca 3.6; Raporti vjetor i NJSBC FSHNH.</i> <i>Evidenca 3.25– Analiza vjetore e FSHNH</i> <i>Evidenca 3.7; Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë</i>			
	<i>Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. Njësia bazë ku realizohet programi i studimit harton raporte analitike, periodike/analiza vjetore mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, kalueshmërinë, frekuentimin dhe diplomimin si dhe punësimit të tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, rezulton se UK bazuar në Rregulloren e UK si dhe Statutin e UK u mundëson studentëve përfaqësimin në organet vendimmarrëse si në: • Senatin Akademik; • Grupet e RBV; • Këshillin studentor në nivel njësie kryesore dhe institucioni • NJSBC; • Komisionin e Kurrikulave; Evidenca:

	<i>Evidenca 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë</i> <i>Evidenca 2.4; Rregullorja e programit të studimit</i> <i>Evidenca 2.2; Rregullore e FSHNH</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	GVJ konstaton se aktualisht FSHNH përfshin studentët në jetën akademike të institucionit. GVJ konstaton se UK përdor sistemin e pyetësorëve me studentët për vlerësimin e stafit akademik dhe lëndëve sipas programeve dhe cikleve të studimit që ata ndjekin. Ajo që bie në sy është përfshirja shumë e ulët e studentëve në plotësimin e pyetësorëve. Përpunimi i të dhënave të pyetësorëve realizohet nga zyra e NJSBC dhe përfundon me hartimin e Raportit të Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorëve (vlerësim me %), i cili u komunikohet organeve drejtuese, individualisht secilit prej pedagogëve, dhe më pas përgjegjësit të njësisë bazë për të analizuar rezultatet dhe marrjen e masave përkatëse. Gjithashtu Departamenti i Infermierisë mirëpret sugjerimet, vërejtjet dhe rekomandimet e studentëve në çdo kohë, nëpërmjet anëtarëve të këshillave studentorë dhe koordinatorit të programit të studimit, por për këtë gjë nuk kemi evidenca konkrete. <u>GVJ sygjeron përfshirjen e sa më shumë studentëve në plotësimin e pyetësorëve.</u> Evidenca: <i>Evidenca 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë</i> <i>Evidenca 1.17; Rregullorja e Këshillit studentor</i> <i>Evidenca 1.18; Rregullorja për organizimin e zgjedhjeve për organet dhe autoritetet drejtuese;</i> <i>Evidenca 3.12– Pyetësor studentor/Raport</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	GVJ konstatoi përfshirjen e studentëve në procese akademike me pjesëmarrje në NJSBC, komisionin e kurrikulave, kërkimin shkencor, GVB, gjë e cila garanton dëgjimin e zërit të studentëve në vendimmarrje. Njësia kryesore dhe ajo bazë, përgjegjëse për këtë program studimi marrin në konsideratë mendimin dhe opinionin e studentëve (vërejtjet, sugjerimet, komentet) nëpërmjet anëtarëve të këshillave studentorë, si dhe nëpërmjet kordinatorit të programit, në lidhje me procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Ndërkohë zyra e NJSBC-së përpunon të dhënat e pyetësorëve, të cilët janë të ndarë vec për stafin akademik dhe vec për lëndët që zhvillohen në këtë program. Ky feedback i jep mundësi reflektimi pedagogut të lëndës për

	problematika që mund të hasen, por edhe më gjerë pasi Përgjegjësi i Departamentit mund të kalojë për diskutim në mbledhje departamenti problematikat e ngritura duke marrë vendime përkatëse në hartim, rishikim dhe përmirësim programi. <u>GVJ sygjeron që të sigurohet pjesëmarrje masive e studentëve më plotësimin e pyetësorëve.</u> Evidenca <i>Evidenca 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë</i> <i>Evidenca 1.2 - Rregullore e UNIKO</i> <i>Evidenca 1.5; Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional</i> <i>Evidenca 2.2; Rregullore e FSHNH</i> <i>Evidenca 1.24 – Manual per vleresimin e performances se stafit Akademik</i> <i>Evidenca 3.12– Pyetësor studentor/Raport</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezulttit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit sanksionohet dhe përcaktohet procedura e vlerësimit të ankesës së studentit për rezultatin e provimit. Procedura dokumentohet qartë në RVB. Në takim me GVJ, studentët shprehen të kënaqur me mënyrën e organizimit të provimeve dhe me mundësitë që ata kanë për ankimim rezultati dhe rishikim të tezës së provimit. Sipas studentëve, por edhe stafit, korrigjimi me Clean Score është mjaft efikas. Nga takimi me stafin akademik dhe studentët u vërejt se fryma në institucion është tepër pozitive. Evidenca: <i>Evidenca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë</i> <i>Evidenca 2.2; Rregullore e FSHNH</i> <i>Evidenca 2.3; Rregullore e njësisë bazë "Departamenti i Infermierisë";</i> <i>Evidenca 1.6.1; Manual i sistemit elektronik pitagora;</i>
Konkluzione	<i>Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit dhe Rregulloret e FSHNH, garantohet e drejta e studentëve ose përfaqësuesve të tyre për pjesëmarrje në organet vendim marrëse dhe këshilluese të UK.</i> <i>-Përfshirja e studentëve në vendimmarrje dhe vlerësim të procesit akademik realizohet përmes përfaqësuesve të tyre në organet e zgjedhura (NJSBC, komisioni i kërkimit shkencor, GVB), por dhe</i>

	përmes tërheqjes dhe vlerësimit të opinionit të tyre në raport me mësimdhënien, praktikën profesionale, përfshirjen në projekte e grupe studimore. Studentët kanë qenë pjesëmarrës dhe në hartimin e RVB. -Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit sanksionohet dhe përcaktohet procedura e vlerësimit të ankesës së studentit për rezultatin e provimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	UK ka në organigramë dhe Qendrën e Karrierës e cila asiston studentët dhe realizon informimin e tyre që nga momenti i regjistrimit e deri në diplomim. Studentët gjithashtu informohen edhe nga faqja e webit. <u>GVJ sygjeron që punonjësit e kësaj Qendre të përpigjen të informojnë më shumë studentët rreth shërbimeve që ofrojnë.</u> Evidenca: Evidenca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë Evidenca 2.2; Rregullore e FSHNH Evidenca Webfaqja e UK https://unkorce.edu.al/ Evidenca 3.1.9– Analiza vjetore e Qendrës së Karrierës dhe ALUMNI Takim me stafin e Qendrës së Karrierës, Standarteve dhe e Sigurimit të Cilësisë
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të	Nga kontakti i GVJ me studentët, konstatoi se ata shpreheshin pozitivisht për aksesin në informacion, për disponibilitetin e sekretarisë për asistimin në aspekte të procesit mësimor, për pjesëmarrjen në aktivitete shkencore, promovuese dhe trajnuese bashkë me pedagogët. Koordinator i programit të studimit, luan një rol të rëndësishëm në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën.

bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi. Njësia përgjegjëse për këtë program studimi administron rrjetet sociale për të krijuar një kontakt më të afërt dhe miqësor me studentët, duke ofruar në këtë mënyrë informacion dhe këshilla që lidhen me programin e studimit. Evidenca: <i>Takimi me studentët</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Nga takimi i GVJ me studentët u konstatua se Qendra e Këshillimit të Karrierës është pjesë përbërëse e strukturës organizative të UK, e cila funksionon në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet promovimit të programeve, informimit dhe orientimit në lidhje me procesin mësimor, shërben si urë lidhëse midis punëdhënësve dhe studentëve, duke mbajtur leksione të hapura, trajnime dhe duke përfshirë studentët në panaiet e punës. Evidenca: <i>Evidenca 3.1.9– Analiza vjetore e Qendrës së Karrierës dhe ALUMNI</i> <i>Evidenca 5.2.8 https://unkorce.edu.al/studentet-qendra-e-karrieres-dhe-alumni/</i> <i>Takimi me studentët</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	GVJ konstatoi nga dokumentet dhe nga takimi me ish studentë se zyra e karrierës realizonin aktiviteti si: Këshillim individual i karrierës, Organizimi i tryezave të rrumbullakta, seminare, konferenca, panaiet e punës, etj. Në këtë formë UK ndjek studentët pas diplomimit dhe monitoron shkallën e punësimit. Por nuk kemi evidenca konkrete lidhur me këto aktivitete për studentët e programit Master Profesional në Infermieristikë. Evidenca: <i>Evidenca 2.20; Jeta studentore dhe veprimtaritë e QKA</i> <i>Evidenca 2.16; Gjurmimi i ecursisë së punësimit (alumni) dhe UISH</i> <i>Takim me studentë dhe ish-studentë</i>
Konkluzione	<i>-UK dhe FSHNH kanë procedurë dhe njësi të posaçme në shërbim të informimit të studentëve në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. Në funksion të informimit</i>

	të studentëve janë struktura të posacme si (Qendra e Karrierës dhe ALUMNI, Sekretaria mësimore, Drejtoria e Standarteve dhe e Sigurimit të Cilësisë, Zyra e IT). -Institucioni ka vënë në shërbim të studentëve Qendrën e Karrierës, që realizon informimin e studentëve dhe të gjitha shërbimet që nga momenti i rregjistrimit deri në diplomim. -Qendra e Karrierës asiston në gjurmimin e studentëve pas diplomimit. Ajo mban lidhje me studentët e diplomuar nëpërmjet adresave të tyre personale të emailit dhe ka krijuar një data-bazë të të dhënave të cilat përditësohen çdo vit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	GVJ në takimin me drejtuesit e institucionit, stafin, studentët, NJSBC, referencat e vëna në dispozicion, mendon se, UK, e ka të ngritur dhe funksional, Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe nëpërmjet NJSBC-së, siguron zbatimin e një strategjie institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. NJSBC, funksionon në formën e një njësie të përhershme në strukturën organizative të institucionit dhe veprimtaria e tij bazohet dhe zbatohet sipas një rregulloreje të miratuar institucionale. Kjo njësi bën të mundur vlerësimin e vazhdueshëm dhe periodik të stafit në lidhje me veprimtarinë

	mësimore dhe kërkimore shkencore nëpërmjet pyetësorëve që ju bëhen studentëve mbi aktivitetin mësimor, aktivitetin shkencor, infrastrukturën e institucionit, komunikimin me sekretarinë, administratën etj. Institucioni nuk disponon një udhëzues specifik për përdorim të metodave inovative, përveç asaj që na referuan vetë anëtarët e stafit, ku vetë ata mundohen të implemenotjnë raste klinike ku studentët luajnë role alternative ekzaminues/pacient, projektet te ndryshme në grupe te vogla studentësh të cilat luajnë rol në inkurajim e studentëve dhe mbështetje në procesin e asimilimit të informacionit. UK nuk ka udhëzues ose manual që nxisin zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se NJSBC pranë UK mbështetur në rregulloren për këtë njësi, synon përmirësimin e rezultateve dhe rritjen e pritshmërive në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, për të përmbushur standartet e cilësisë të përcaktuar nga UK, në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të lartë. Përmirësimi i cilësisë realizohet nëpërmjet: kontrollit të brendshëm dhe vlerësimit të jashtëm. Mekanizmat kryesorë që përdoren janë: • Pyetsori i studentëve; • Formular i performancës akademike; • Monitorimi i vazhdueshëm i procesit mësimor nga përgjegjësi i departamentit; Rezultatet i vihen në dispozicion departamentit, dekanit, rektorit, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e cilësisë, por edhe vënia në pah e sygjërimeve të studentëve. Në mungesë të një manuali mbi metodat e mësimdhënies nuk ka një mekanizëm të plotë të fushës mjekësore të monitorimit të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. Evidenca <i>Evidenca 1.1. Statuti i UNIKO nëni 85</i> <i>Evidenca 1.16 Manuali i cilësisë së UNIKO</i> <i>Evidenca 2.3 Rregullore të DI</i> <i>Evidenca 1.5; Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe</i>

	<i>Vlerësimi Institucional</i> <i>Evidenca 3.6; Raporti vjetor i NJSBC FSHNH</i> <i>Evidenca 3.7; Analiza vjetore e Njesisë Bazë</i> <i>Evidenca 3.12. Raporti pyetjeësorëve të studentëve</i> <i>Evidenca 1.24 për vlerësimin e performancës së stafit</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	UK ka përfshirë studentët në NJSBC, GVB dhe Senat akademik ku ata kanë mundësi të japin mendimin e tyre në lidhje me vlerësimin periodik të formave të mësimdhënies, vlerësimit të dijeve dhe trajtimit të ankimeve. Ndërkohë mbështetur në rregulloren e UK studentët përfshihen rregullisht në vlerësimin e stafit akademik dhe programit të studimit nëpërmjet plotësimit të formularëve që shpërndan NJSBC, për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik dhe përmbajtjen e lëndës, duke dhënë vlerësimin dhe komentet për përmirësimin e këtij program studimi, si në funksion të mësimdhënies, ashtu edhe të kurrikulës. <u>GVJ konstaton se përfshirja e studentëve në plotësimin e këtyre pyetjeësorëve është shumë e ulët.</u> Evidenca: <i>Evidenca 2.3 Rregullore të DI</i> <i>Evidenca 1.5; Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional</i> <i>Evidenca 3.6; Raporti vjetor i NJSBC FSHNH</i> <i>Evidenca 3.7; Analiza vjetore e Njesisë Bazë</i> <i>Evidenca 3.12. Raporti pyetjeësorëve të studentëve</i> <i>Evidenca 1.24 Manuali për vlerësimin e performancës së stafit</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Sic u theksua më lart pranë UK funksionon NJSBC, e cila në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetësin e studentëve. Në fund të çdo semestri kjo strukturë shpërndan pyetësin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi. Institucioni harton raportin në fund të çdo viti akademik, i cili publikohet në faqen zyrtare të Universitetit, me qëllim rritjen e transparencës ndaj të gjithë aktorëve të përfshirë nga institucioni. <u>GVJ konstaton se përfshirja e studentëve në plotësimin e këtyre pyetjeësorëve është shumë e ulët.</u>
	Raporti 2023-2024 nuk paraqitet i publikuar në faqen zyrtare të UK sipas evidencave të paraqitura nga NJSBC e UNIKO.

	Evidenca: <i>Evidenca 1.5; Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional</i> <i>Evidenca 1.16 Manuali i cilësisë së UNIKO</i> <i>Evidenca 1.9 Rregullore për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale</i> <i>Evidenca 2.3 Rregullore të DI</i> <i>Evidenca 3.6; Raporti vjetor i NJSBC FSHNH</i> <i>Evidenca 3.7; Analiza vjetore e Njesisë Bazë</i> <i>Evidenca 3.12. Raporti pyeteësorëve të studentëve</i> <i>Evidenca 1.24 Manuali për vlerësimin e performancës së stafit</i>			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Referuar vizitës në Institucion, në takimin me stafin akademik të këtij program studimi GVJ konstatoi gadishmërinë e Institucionit për mbështetje për stafin akademik, si në funksion të realizimit të një procesi mësimor cilësor (kryesisht në infrastrukturë), ashtu edhe në funksion të kualifikimit shkencor (nxitja për pjesëmarrje në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit, nxitja dhe mbështetja financiare për të botuar artikuj në revista me faktor të lartë impakti- Scopus, monografi dhe botime të ngjashme shkencore). Për këtë të fundit, stafi i Departamentit të Infermierisë njëzëri kërkuan mbështetje për një kualifikim shkencor sa më të mirë. Evidenca: <i>Takim me drejtuesin e Njesisë Kryesore, drejtuesin e Njesisë Bazë, stafin akademik.</i>			
Konkluzione	<i>UK ka ngritur dhe ka funksional sistemin e sigurimit të cilësisë dhe monitoron e vlerëson përmes njësive të posacme në mënyrë periodike programet e studimit. Ky sektor në zbatim të ligjit të Arsimit të Lartë dhe akteve nënligjore, shpërndan në fund të çdo semestri pyetësorët për matjen performancës dhe cilësinë e mësimdhënies. Rekomandojm që është shumë e rëndësishme që pyetësorët të shpërndahen tek të gjithë studentët për të patur një informacion më të saktë dhe më të gjerë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë 80/2015 dhe Kodi i Cilësisë në Arsimin e Lartë (VKM 531/11.09.2018), UK ka ndërtuar politika dhe procedura si dhe ka ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë janë sanksionuar në statutin e UK dhe në rregulloren e institucionit. Gjatë guidës në institucion GVJ u informua se në mënyrë të vazhdueshme, realizohet një pyetësor anonim me studentët, me disa rubrika për mësimdhënien, programin, korrektësinë e stafit, ky vlerësim menaxhohet nga, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Evidenca: <i>Evidenca 1.3; Plani Strategjik i zhvillimit të Universitetit F. S. Noli 2022-2027</i> <i>Evidenca 1.16; Manuali i cilësisë UK;</i> <i>Evidenca 1.5; Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional</i> <i>Vizita në institucion</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Në UK sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë realizohet nëpërmjet Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional (DKVI). Brenda kësaj drejtorie funksionon NJSBC, e cila ka përfaqësues nga çdo njësi kryesore, nga Drejtoria e Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional (DKVI), organizatat studentore dhe një ekspert të jashtëm. Kjo strukturë përbëhet nga 8 anëtarë, nga këta 4 janë personel akademik, 2 janë personel nga administrata, 1 përfaqësues i studentëve dhe 1 ekspert i jashtëm. UK ka monitorim të përvitshëm nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve për plotësimin e standardeve, gjë që siguron funksionimin e kontrollit të cilësisë. Evidenca: <i>Evidenca 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë</i> <i>Evidenca 1.16; Manuali i cilësisë UK;</i>

	<i>Evidenca 1.5; Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, RVB, dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në UK realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL. Një nga këto instrumenta është Sondazhi Kombëtar i Studentëve i organizuar nga ASCAL. Konkretisht, UK ka plotësuar standartet institucionale dhe është akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 02, datë 27.01.2023, për 4 vite. Evidenca: <i>Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit Fan S. Noli</i> <i>Shtojca 1.2 Rregullorja e Uniko.</i> <i>Shtojca 1.3 Plani strategjik i zhvillimit të Uniko</i> <i>Evidenca 1.16; Manuali i cilësisë UK;</i> <i>Evidenca 2.1.1; çertifikatë dhe vendim akreditimi institucional i UK (marrë nga evidencat e programit Bachelor në Infermeri të Përgjithshme)</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	GVJ konstatoi se UK ka një komunikim të mirë nga poshtë lart dhe anasjelltas. Gjithashtu me anë të kontrollit të cilësisë dhe raportimit të tyre, UK arrin të promovojë arritjet më të mira. NJSBC përpunon të dhënat duke llogaritur tregues sasiore dhe cilësorë në lidhje me cilësinë e procesit mësimor në këtë institucion. Raportet e përgatitura iu dërgohen të gjithë strukturave sipas përcaktimeve në rregulloren e kësaj njësie. Strukturat drejtuese dhe në vecanti Departamenti i Infermierisë përgjegjës për këtë program studimi, marrin vendimet përkatëse në funksion të përmirësimit të cilësisë dhe mbarëvajtjes së programit studimor, megjithatë nuk kemi evidencat konkrete të treguesve të matshëm për këtë program studimi. Evidenca: <i>Evidenca 1.16; Manuali i cilësisë UK;</i> <i>Evidenca 1.5; Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional</i> <i>Evidenca 2.25. Analiza evjetore e njësisë kryesore FSHNH</i> <i>Shtojca 3.6 Raportet Vjetore të NJSBC</i>

Konkluzione	Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë, institucioni ka ndërtuar politika dhe procedura si dhe ka ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë janë sanksionuar në statutin e UK dhe në rregulloren e institucionit. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë funksionon si një strukturë autonome dhe e përhershme pranë institucionit dhe funksionon me plan pune vjetor dhe ushtron një seri aktivitete bazuar në rregulloren NJSBC. <u>GVJ rekomandon që NJSBC të zhvillojë fushata informuese tek studentët lidhur me rolin e saj dhe të jetë sa më pranë studentëve.</u>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe	Të gjitha gjetjet e vlerësimit vjetor janë pjesë e raportit vjetor të NJSBC. GVJ konstatoi se UK kryen një vlerësim të brendshëm vjetor që përfshin gjithë programet, njësitë kryesore/bazë dhe ndihmëse që e paraqet në një raport vjetor të Universitetit i cili gjithashtu dërgohet në MAS. <u>GVJ rekomandon rritjen e efikasitetit në analizimin e informacionit dhe të dhënave, në përpilimin e rekomandimeve më të detajuara dhe një plani pune me adresim konkret të problematikave.</u> Evidenca: <i>Evidenca 1.1 Statuti i UNIKO</i> <i>Evidenca 1.2 Rregullorja e UNIKO</i> <i>Evidenca 1.24 Manual për vlerësimin e performancës së stafit Akademik</i> <i>1.5; Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional</i> <i>Evidenca 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH</i>

vendimmarrëse për programin e studimit.	<i>Evidenca 3.25 Analiza vjetore të FSHN</i> <i>Evidenca 3.7 Analiza vjetore të DI</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, rezultoni se në mbledhjet e departamentit në fund të çdo viti mësimor analizohet ecuria dhe mbarëvajtja e gjithë procesit mësimor, si dhe problematikat e evidentuara nga pyetësorët e studentëve, pyetësorët për stafin akademik dhe joakademik si dhe formularët e vetvlerësimit. Ky informacion përfshihet në raportin e analizës vjetore të veprimtarisë së departamentit që u komunikohet strukturave të UK sipas parashikimeve të kuadrit rregullator përkatës. Në fund bëhet një analizë mbi gjetjet dhe shprehen mundësitë e përmirësimit dhe rekomandohen plan masat, <u>por nuk kemi një evidencë me adresim problematikash dhe zgjidhjen që ato kanë marrë nga viti në vit.</u> Evidenca: <i>Evidenca 3.25 Analiza vjetore të FSHN</i> <i>Evidenca 3.7 Analiza vjetore të DI</i> <i>Takim me drejtuesin e Nësisë Kryesore, drejtuesin e Njësisë Bazë, stafin akademik</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare, si: provimi i	GVJ konstatoi se UK përdor metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë dhe mbarëvajtjen e programit. Diskutimet e hapura të stafit akademik me studentët në lidhje me procesin mësimor, cilësinë e mësimdhënies, të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësimeve të provimeve apo detyrave të kurseve, etj, janë metoda e drejtpërdrejte që UK përdor të sigurar vlerësimin e cilësisë. Gjithashtu dhe informacioni i marrë nga UISH. Nuk plotësohet në mënyrë të plotë për programin Master ky kriter, për arsye sepse nuk paraqitet dhe me evidencë një ndryshim në kurrikule apo syllabus. Evidenca: <i>Evidence 1.1 Statuti i UNIKO</i> <i>Evidence 1.16 Manuali i cilësisë së UNIKO</i> <i>Evidence 1.2 Regullorja e UNIKO</i> <i>Evidence 3.25 Analiza vjetore të FSHN</i> <i>Evidence 3.6 Raportet vjetore të NJSBC</i>

shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	<i>Evidence 3.7 Analiza vjetore te DI</i> https://unkorce.edu.al/			
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	UK në kuadër të vlerësimit të cilësisë për programet e studimit përdor mekanizmat e mëposhtëm kryesorë: • Sondazhe nëpërmjet pyetësorëve të studentëve; • Raportet e stafit akademik gjatë vitit shkollor dhe • Informacioni nga UISH në lidhje me rezultatet në provimin e licencës; Evidenca: Evidence 1.1 Statuti i UNIKO Evidence 1.16 Manuali i cilësisë së UNIKO Evidence 1.2 Regullorja e UNIKO Evidence 1.24 Manual për vlerësimin e performancës së stafit akademik			
Konkluzione	-UK përdor mekanizmat e procese formale të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikqyrjen e herë pas herëshme të programit të studimit. -Disa nga instrumentat e përdorur janë pyetësorët e studentëve për procesin e mësimdhënies, si dhe analizat periodike të punës në nivel departamenti. Vlerësimi i performancës së personelit akademik dhe ndihmës akademik. -Në procedurat e realizuara në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, rezultatet e proceseve të anketimit të studentëve paraqiten në Raportin vjetor të institucionit dhe në raportin vjetor të NJSBC. -Një formë tjetër është edhe raporti nga UISH.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	GVJ evidentoi se në përbërje të NJSBC janë 7 anëtarë, 4 përfaqësues të personelit akademik të njësive kryesore, një përfaqësues i dekanit të Kurrikulës, Vlerësimin Institucional dhe Alumni, një përfaqësues i Drejtorisë Ekonomike dhe një përfaqësues i studentëve. Në këtë mënyrë garantohet se politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshijnë aktorë të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Struktura më aktive në këtë proces është NJSBC, e cila bashkëpunon ngushtë me të gjithë strukturat e tjera dhe vecanërisht me njësinë bazë, për përmirësimin e rezultateve dhe rritjen e pritshmërive në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në përputhje me standardet e cilësisë së UK, si dhe në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Strukturat e Sigurimit të Cilësisë kanë për detyrë të garantojnë politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë. Studentët janë të përfshirë si në hartimin e RVB-së, ashtu edhe për vlerësim të jashtëm pranë ASCAL, sikurse janë të përfaqësuar në Senat, në NJSBC. Ajo c'ka nuk evidentohet është prezencja e raporteve analitike në lidhje me këtë program. Evidenca: <i>Evidenca:</i> 1.16; Manuali i cilësisë UK; <i>Evidenca</i> 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH. <i>Evidenca</i> 1.5; Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimin Institucional
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	GVJ u informua nëpërmjet takimit që zhvilloi me stafin dhe studentët, për faktin e përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik institucional nëpërmjet anketimeve, edhe pse përqindja e tyre ishte shumë e ulët. Kështu Rregullorja e FSHNH dhe e Departamentit të Infermierisë përcakton qartësisht detyrat konkrete për pozicionet individuale dhe njësitë në raport me sigurimin e cilësisë. GVJ konstatoi se të gjithë aktorët e përfshirë në proces ishin bashkëpunues dhe të koordinuar për të realizuar një proces sa më korrekt me vetëbesim për punën dhe kapacitetet e tyre. Studentët u shprehën entuziastë për programin e studimit. Ata

	referuan se janë të përfshirë në vetëvlerësim përmes pyetësorëve, edhe pse numri i studentëve të përfshirë ishte shumë i ulët, propozimeve të këshillit studentor si dhe përmes përfaqësuesve të tyre në GVB. <i>GVJ sygjeron rritjen e numrit të studentëve në plotësimin e anketimeve për shkak të përqindjes shume të ulët që rezultoi nga dokumentacionet përkatëse.</i> Evidenca: <i>Evidenca 1.3; Plani Strategjik i zhvillimit të Universitetit F. S. Noli 2022-2027</i> <i>Evidence 2.3 Rregullore e DI</i> <i>Evidence 2.4 Rregullorja e programit të studimit Master Profesional në Infermieristikë</i> <i>Evidenca 3.6 Raporti vjetor i NJSBC FSHNH</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	GVJ, gjatë vizitës në institucion dhe bisedave të zhvilluara, me drejtues, stafin akademik, dhe jo vetëm, si edhe me studentët, konstaton dhe mund të pohojmë një gjithëpërfshirje në procesin e veprimtarisë së NJSBC të pedagogëve, stafit administrativ, të cilët organizohen në mbledhje të vazhdueshme mujore të Departamentit si hallka e parë e shprehjes së nevojave për përmirësime apo ndryshime në programet e studimit. GVJ konstatoi se në përbërje të NJSBC ka përfaqësues të njësisë kryesore, njësisë bazë, anëtarë të personelit akademik dhe përfaqësuesin e studentëve. Evidenca: <i>Evidenca 1.1 Statuti i UNIKO</i> <i>Evidenca 1.16 Manuali i cilësisë së UNIKO, Kodin e cilësisë (ASCAL)- link</i> <i>Evidence 2.4 Rregullorja e programit të studimit Master Profesional në Infermieristikë</i> <i>Evidenca 3.6 Raporti vjetor i NJSBC FSHNH</i> <i>Takim me Drejtuesin e Njësisë Kryesore dhe Bazë;</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë	GVJ mendon se UK është i angazhuar në respektimin e integritetit akademik dhe në shmangien e çdo diskriminimi apo pabarazie të të gjithë palëve në këtë proces vlerësimi. Përzgjedhje e aktorëve të brendshëm në proceset periodike të vlerësimit bëhet nga personeli akademik ku merren parasysh disa kriterë të përfshirjes si, performanca akademike, integriteti, kompetencat profesionale;

çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	mundësitë për grumbullimin e informacionit dhe përpunimin e tij me qëllim realizimin e vlerësimeve të ndryshme. Instrumenti kryesor i vlerësimit të programit të studimit, pyetësori, është realizuar në kushte të plota anonimiteti. Nuk janë referuar ankesa nga personeli apo studentët për diskriminim apo pabarazi. Në procesin e vlerësimit respektohet integriteti akademik dhe shmanget cdo lloj forme diskriminimi apo pabarazie kundrejt stafit akademik apo studenteve. Evidenca: Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit Fan S. Noli Evidenca 1.2 Rregullorja e Uniko. Evidenca 1.19; Kodi i Etikës UNIKO
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Qëllimi i NJSBC është arritja e objektivave strategjike në përputhje me vizionin dhe misionin e institucionit. NJSBC funksionon me bazë Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë; legjislacionit në fuqi, si dhe rregulloreve të brendshme të UK dhe Statutit të UK. Përveç vlerësimit të brendshëm periodik të programit, element tjetër i sigurimit të cilësisë është dhe vlerësimi i jashtëm i cili koordinohet nga ASCAL dhe shërben për sigurimin të cilësisë, në lidhje me programin e studimit. Ky vlerësim kryhet nëpërmjet hartimit të raporteve të vlerësimit të brendshëm, dhe më pas nga GVJ me anë të RVJ, pasqyrohet gjendja aktuale dhe jepen rekomandime me qëllim përmirësim të përmbushjes së standardeve të cilësisë. GVJ konstatoi se detyrat dhe roli i anëtarëve të NJSBC përcaktohen në rregulloren e funksionimit të NJSBC. Për një vlerësim më objektiv të programit të studimit dhe gjetjen e instrumentave më të mirë për përmirësim dhe përshtatje me tregun e punës, NJSBC organizon takime në nivel institucional e deri në nivel programi me pale të interesuara si punëdhënës të tregut publik apo privat dhe studentë Alumni. Evidenca: Evidenca 2.9; Marrëveshjet e bashkëpunimit në mbështetje të praktikave; Evidenca 3.11; Studim tregu për programin e studimit Webfaqja e UK https://unkorce.edu.al/ Takim me stafin akademik Takim me studentët
Konkluzione	<i>Bazuar në statutin, rregulloren dhe planin strategjik të zhvillimit</i>

	të Universitetit F.S.Noli, institucioni ka hartuar procedura dhe politika për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Prania e studenteve si anëtarë krijon mundësinë e bashkëveprimit të studentëve me studentët për të përfituar ndjesinë e tyre dhe për të bërë efektiv kontributin e tyre në sigurimin e cilësisë së programit të studimit. GVJ rekomandon përfshirjen në rregullore të NJSBC edhe të aktoreve të jashtëm me qëllim përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. -NJSBC funksionon në nivel institucioni dhe koordinon sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në të gjithë UK.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ konstatoi se aktiviteti, programi, rregullore të ndryshme të funksionimit të UK janë të aksesueshëm nga stafi akademik, ndihmës-akademik dhe studentët. Gjithashtu çdo informacion në lidhje me politikat dhe praktikak që lidhen me sigurimin e Cilësisë në UK janë transparente dhe publike për të gjithë palët e interesuara dhe shfaqen në faqen zyrtare web të UK. Evidenca: <i>Evidenca Webfaqja e UK https://unkorce.edu.al/</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	GVJ nga kontakti me përfaqësues të institucionit dhe shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar prej UK konstaton se institucioni respekton lirinë dhe etikën akademike dhe po ashtu të dhënat personale. UK ka të miratuara rregullore të funksionimit të programeve si dhe për ruajtjen e të dhënave ku përcaktohet detyrimi për mbrojtjen e të dhënave. Në faqen Web publikohen të gjitha politikat dhe praktikak e sigurimit të cilësisë të cilat janë të aksesueshme për të gjithë. Deklarohet që NJSBC harton në mënyrë periodike raporte të

	vlerësimit të brendshëm, të cilat si fillim i përcillen Rektoratit dhe Senatit Akademik e më pas ruhen në arkivën e FSHNH dhe UK dhe janë të publikuara në faqen web të UK (nuk evidentohet kjo). Evidencat: <i>Evidenca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë</i> <i>Evidenca 1.9; Rregullore për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	GVJ bazuar në evidencat dhe në RVB evidentoi se Departamenti i Infermierisë, FSHNH dhe UK, vlerësojnë në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore – shkencore. Raportet e hartuara për këtë qëllim evidentojnë arritjet në procesin mësimor dhe atë kërkimor gjatë një viti akademik, si dhe problematikat që shfaqen. Kështu në fund të çdo viti akademik publikohet raporti vjetor i cili i përcillet senatit akademik, por nuk kemi një evidencë të qartë rreth planit të masave që për përmirësimin e mangësive që evidentohen. <i>GVJ rekomandon hartimin e një plani masash për rritjen e cilësisë. Nuk ka raport analitik për këtë kriter në nivel program dhe departamenti</i> Evidencat: <i>Evidenca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë</i> <i>Evidenca 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH</i> <i>Evidenca 2.3; Rregullore e njësisë bazë "Departamenti i Infermierisë";</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konstatoi se UK për të siguruar monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së programit të studimit, mbledh Senatin Akademik të UK për të monitoruar implementimin e përmirësimit të procesit mësimor, ku hartohet dhe një raport vjetor. Në këtë raport shqyrtohen problematikat dhe veprimet që duhen të ndërmerren për të siguruar përmirësimin, por sikurse e kemi thënë edhe më sipër nuk kemi një evidencë të një plani masash për rritjen e cilësisë. Evidencat: <i>Evidenca 2.4.; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK</i>

	<i>Evidenca: 3.6; Raporte vjetore i NJSBC FSHNH</i>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Nga takimi në institucion na u komunikua që Dekanati zhvillon takime periodike me Këshillin Studentor të cilat kanë për qëllim informimin dhe marrjen e opinionit të studentëve. Organizimi i pyetësorë tek studentët janë një mekanizëm shumë i mirë për të marrë sa më shumë informacion, por nga konstatimet rezultoi se numri i studentëve të përfshirë në plotësimin e pyetësorëve ishte jashtzakonisht i ulët. <u>GVJ rekomandon marrjen e masave për të përfshirë të gjithë studentët në plotësimin e pyetësorëve.</u>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Infermieristikë” ofruar nga Institucioni Arsimit të Lartë Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë.

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Numri i stafit akademik në vite është i qëndrueshëm dhe i gjithë personeli akademik i UNIKO/DI kanë grada akademike dhe disa janë në proces.
2. Stafi mbikqyrës i praktikës profesionale i raportuar nga Institucioni, bazuar dhe në Statutin e UNIKO, janë staf i spitalit të Korcës dhe kjo është një pikë e fortë për këtë program studimi.
3. Pjesa më e madhe e studentëve që kanë përfunduar këtë program studimi janë të punësuar.
4. Nga takimi me studentët dhe stafin akademik u evidentua se një pjesë e vetë stafit akademik shërben si treg pune, duke punësuar ish studentët e tyre apo i kanë referuar tek

kolegët e tyre për punësim në klinikat private.

Pika të dobta:

1. Plan i mësimor nuk është i përafuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 823, datë 28.12.2023. Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar. Ky vendim është pasqyrim i direktivave europiane të profesioneve. (Standardi III.4/Kriteri 1)
2. Ngrohja me orar të kufizuar në periudhën e dimrit të zgjatur, ul shfrytëzimin maksimal të mjediseve nga ana e studentëve që të përmirësohet infrastruktura laboratorike për të bërë testimin e njohurive praktike. (Standardi III.6/Kriteri 1,2)
3. Mungesa e stafit PAE me titull "Profesor", vështirëson dhe krijon mangësi në përmbushjen e një detyrimi të nevojshëm të diskutimit dhe miratimit të programeve lëndore (Syllabuseve) nga titullari i lëndës, i fushës përkatëse, me titullin dhe gradën e kërkuar në ligj. (Standardi II.2/Kriteri 1)
4. Biblioteka e FSHNH, e cila për arsye objektive të përkohëshme është në proces rristrukturimi, krijon një boshllëk në shfrytëzimin e librit fizik dhe mjediseve për studim, edhe pse kompensohet nga biblioteka qendrore. (Standardi IV.3/ Kriteri 3,6)

Rekomandime:

1. (Standardi I.1/Kriteri 5) Duhet të përmirësohet sepse nuk është në fushën akademike të njësisë kryesore, duke rekomanduar togfjalëshin "Shkencave të shëndetit ose mjeksore".
2. (Standardi II.1) GVJ rekomandon që ky plan mësimor nevojitet të ndryshohet dhe përshtatet me Vendim Nr. 823, datë 28.12.2023: Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin NR. 41, DATË 24.1.2018, të këshillit të ministrave, "PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË", të ndryshuar.
3. (Standardi II.1) GVJ rekomandon që të grupohen lëndët dhe modulet.
4. (Standardi II.3) GVJ evidenton që ka predispozitë nga ana e stafëve që të shtojnë orët e praktikave, por VKM nr. 41 i ka kufizuar për shkak të nenit 2.1. të vendimit nr. 41, datë 24.1.2018 PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË.
5. (Standardi II.3) GVJ evidenton që nuk ka një procedurë të përmirësimit të syllabusit dhe rekomandon që të përfshihet NJSBC në këtë proces, ose të ndahet DI në grupe mësimore/shkencore.

6. (Standardi II.5/ kriterin 1) GVJ evidenton që nuk ka evidencë të tillë që është përshtatur apo riorganizuar. Për kriterin 3 ka marrëveshje me aktorë të ndryshëm, por nevojitet që të ketë raporte analitike në lidhje me vijueshmërinë dhe përmirësimin e programit.
7. (Standardi III.1/ kriterit 2) GVJ rekomandon të pasqyrohen në syllabus format mësimore si psh raste klinike apo forma të tjera. GVJ evidenton se nuk ka trajnime apo manuale të mësimdhënies që ndihmojnë pedagogun dhe studentin në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Rekomandohet që në vitin e ri akademik të ri të miratohet në senat.
8. Standardi III.2: GVJ rekomandon që të përmirësohet infrastruktura laboratorike për të bërë testimin e njohurive praktike. GVJ e konsideron këtë një praktikë të mirë që UK duhet të vazhdojë ta ndjekë por rekomandon që pyetësori të realizohet në nivel programi, duke qënë se dhe njësia kryesore nuk është në profilin e shkencave të shëndetit dhe mjeksore.
9. (Standardi III.5) GVJ evidenton që nuk paraqitet ndonjë evidencë që ndonjë nga lektorët ndihmon studentët në realizimin e pyetësoreve apo matjeve të ndryshme për qëllime studimore të studentëve.
10. Standardi IV.2: GVJ rekomandon programe profesionale për zhvillimin e praktikave në kuadër të simulacioneve apo rasteve studimore/klinike.
11. Standardi IV.3: Rekomandohet platforma e menaxhimit akademik si psh Moodle, Smart etj. GVJ evidenton që ka nevojë për përmirësim në dokumentacion në lidhje me tekstin e miratuar në departament dhe ka një praktikë të shkruar për miratimin e planeve mesimore, psh duke kaluar nga titullari lëndës, kordinatori programit apo dhe drejtuesi i grupit mësimor/shkencor.
12. Standardi IV.5: Rekomandohet që krahas raportit financiar në nivel institucional të bëhet një raportim i tillë edhe në nivel programi. Universiteti garanton qëndrueshmërinë financiare për realizimin e objektivave dhe misionit të tij.
13. Standardi VI.1: Rekomandohen udhëzues ose manuale që nxisin zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, si edhe rekomandohet përgatitja e evidencave të publikimit të raportit të studenteve në lidhjen me mësimdhënien.

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Professional Master in "Nursing" offered by the Higher Education Institution "Fan S. Noli" University, Korça.

Strengths and affirmations:

1. The number of academic staff over the years is stable and all academic staff of UNIKO/DI have academic degrees and some are in the process.

2. The supervisory staff of professional practice reported by the Institution, based on the Statute of UNIKO, are staff of the Korca hospital and this is a strong point for this study program.
3. The majority of students who have completed this study program are employed.
4. From the meeting with students and academic staff, it was evident that part of the academic staff themselves serves as a labor market, by employing their former students or referring them to their colleagues for employment in private clinics.

Weaknesses:

1. The curriculum is not aligned with the Decision of the Council of Ministers No. 823, dated 28.12.2023. On some additions and changes to the Decision No. 41, dated 24.1.2018, of the Council of Ministers, "On the elements of study programs offered by higher education institutions", as amended. This decision is a reflection of the European directives on professions. (Standard III.4/Criterion 1)
2. Limited-hour heating during the prolonged winter period reduces the maximum use of the facilities by students in order to improve the laboratory infrastructure for testing practical knowledge. (Standard III.6/Criteria 1,2)
3. The lack of PAE staff with the title of "Professor" makes it difficult and creates shortcomings in fulfilling a necessary obligation of discussing and approving subject programs (Syllabuses) by the head of the subject, of the relevant field, with the title and rank required by law. (Standard II.2/Criteria 1)
4. The ASFNH library, which for temporary objective reasons is in the process of restructuring, creates a gap in the use of physical books and study facilities, although it is compensated by the central library. (Standard IV.3/Criteria 3,6)

Recommendations:

1. (Standard I.1/Criterion 5) It needs to be improved because it is not in the academic field of the main unit, recommending the phrase "Health or medical sciences".
2. (Standard II.1) GJV recommends that this curriculum needs to be amended and adapted to Decision No. 823, dated 28.12.2023: On some additions and changes to Decision No. 41, DATED 24.1.2018, of the Council of Ministers, "ON ELEMENTS OF STUDY PROGRAMS OFFERED BY HIGHER EDUCATION INSTITUTIONS", as amended.
3. (Standard II.1) GJV recommends that the subjects and modules be grouped.

4. (Standard II.3) GVJ evidences that there is a predisposition on the part of the staff to increase the hours of internships, but the Council of Ministers No. 41 has limited them due to Article 2.1. of Decision No. 41, dated 24.1.2018 ON ELEMENTS OF STUDY PROGRAMS OFFERED BY HIGHER EDUCATION INSTITUTIONS.

5. (Standard II.3) GVJ evidences that there is no procedure for improving the syllabus and recommends that the NJSBC be included in this process, or that DI be divided into teaching/scientific groups.

6. (Standard II.5/criterion 1) GVJ evidences that there is no evidence that it has been adapted or reorganized. For criterion 3, there is agreement with various stakeholders, but analytical reports are needed regarding the continuity and improvement of the program.

7. (Standard III.1/criterion 2) GVJ recommends that teaching formats such as clinical cases or other forms be reflected in the syllabus. GVJ highlights that there are no training or teaching manuals that assist the lecturer and the student in the teaching and learning process. It is recommended that this be approved by the Senate in the new academic year.

8. Standard III.2: GVJ recommends that the laboratory infrastructure be improved to test practical knowledge. GVJ considers this a good practice that UK should continue to follow but recommends that the questionnaire be implemented at the program level, since the main unit is not in the health and medical sciences profile.

9. (Standard III.5) GVJ highlights that there is no evidence that any of the lecturers assist students in completing questionnaires or various measurements for student study purposes.

10. Standard IV.2: GVJ recommends professional programs for the development of practices within the framework of simulations or case studies/clinical.

11. Standard IV.3: An academic management platform such as Moodle, Smart, etc. is recommended. GVJ highlights that there is a need for improvement in documentation regarding the text approved in the department and has a written practice for the approval of teaching plans, for example by going through the course head, program coordinator or the head of the teaching/scientific group.

12. Standard IV.5: It is recommended that in addition to the financial report at the institutional level, such reporting be made at the program level. The university guarantees financial sustainability for the realization of its objectives and mission.

13. Standard VI.1: Guidelines or manuals that promote the development and use of different and innovative teaching methods are recommended, as well as the preparation of evidence of the publication of student reports in relation to teaching

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR			X	